

EQREM ÇABEJ

STUDIME RRETH ETIMOLOGJISË SË GJUHËS SHQIPE XVI

O.

oficér m. Fjalë e re, që mungon te G. Meyeri. Në Rev. Intern. d. Et. Balkaniques II 176 e spiegonim nga rum. *ofiter*. Më fort nga gjerm. *Offizier*, me anë të trupave të monarkisë austrohungareze, duke u zëvendësuar fundori *-ier* me formantin *-ér* që gjindet dhe te *rreshτέρ, kaptér, togér*. Për këtë mendim flet dhe rrethana që në Shkodër dikur — nganjëherë edhe sot — ndihet *oficier*. Për monoftongimin khs. dhe *ofice*, më e vjetër *oficie*.

okër m., f. «lloj drithi». Pas Q. Haxhihasanit (Bul. për Shk. Shoq. 3, 1955, 182) në Sulovë shënon *Triticum monococcum*, pas I. Mitrushit «*Lathyrus ochrus, Acker-Platterbse, gesse ochre*». E ka dhe N. Fra-shëri te Gjithësija 52. Në Leusë të Përmetit edhe emri topik *Okrishtë* (S. Izgari, Vis. e Kombit XIII 168), pra «arë që ka qenë mbjellë okër». Okri përdoret më fort për bullgur sesa për miell buke. Nga gr. e vj. *ὄχρος* «*Lathyrus cicera*» (te Aristoteli e te Teofrasti), për të cilën sh. Boisacq 1085. Reflektimi i *χ*-së greke me *k* (si te *lakër, mokër*) e vendon këtë huazim në mënyrë të prerë në periodën e greqishtes së vjetër, duke përjashtuar kështu greqishten e mesme e të renë. Hyn në huazimet greke të vjetra të shqipes nga bota e bimësisë, sidomos të bimëve të kultivuara, që përdoren për ushqim të njeriut e për tagji kafshësh. Sh. për këto Thumb IF 26, lvv., 19, Jokl LKU 208, IF 44, 24, Sandfeld 25 vv., e tani dhe vretjtet tona te Bul. i Univ. Shtet. të Tiranës. Seria Shk. Shoq. 4 (1962) 130, 145. Një huazim nga gr. e re *ὄχρος* është *oxistër* te G. Meyeri 315. Këtu *χ*-ja greke reflektohet rregullisht me *χ*².

okóll «rreth e përqark». Huazim krahinor nga sllav. (serbokr., bullg.) *okolo*, G. Meyer 315, Selishev 197, 303.

Te Junggu edhe si emër *okóll*-i m. «partito, fazione», te Bashkimi «raunanza di molti seduti in giro», Cordignano dhe me shtesën «il luogo dell' adunanza», *fusha e okollit*. *Okóll* edhe emër vendi përmbi Bogë. Në Pogradec pas Mannit dhe *okolle* «valle që këcehet trojro»: femërore, pas *valle-s*, në të parë mbase atribut i kësaj (*valle*² *okolle*). Te geg. *rrokóll* «keq e tukeq; rrokopujë, si në tatëpjetë» kemi një për-zjerje të *okoll*-it me *rrotull*, sh. edhe Mann 441.

oratë f. «Sparus auratus, Chrysophrys aurata; Dentex dentex, D. vulgaris». Fjalë e bregdetit të Shqipërisë së mesme (Durrës me rrethe), Veriu *orade*. Trajta *oratë* nga it. *orata*, e *orade* nga ven. *orada* «Sparus auratus». Prej venecianishtes dhe gr. e re *ὄράδα*, G. Meyer NSt IV 67. Për ven. *orada* sh. Boerio 453. Për përhapjen e fjalës latino-romane në brigjet lindore t'Adriatikut khs. Bartoli, Italia e Croazia 108vv., 143.

orendí-të fpl. «mobiljet e shtëpisë, të zyrës etj.; veglat bujqësore, armiset». Jo nga it. *arredo* «orendi, vegël» (G. Meyer 316), po nga sllav.

orodije «vegël», sikundër e pa Pedersen KZ 33, 537 shën. 1. Për ruajtjen e vokalit nazal të sllavishtes në shqipen sh. Jokl Studien 106, 112, Slavia XIII 638, Vasmer Studien I 61, Selisçev 173,291, Bariç Arhiv za arb. starinu I 155, Hýmje 74.

Si fjalë e toskërishtes (Kristoforidhi e jep për Përmet) rrjedh nga bullgarishtja, po nga bullg. e vjetër, me vokal nazal të ruajtur. Fjalë me përhapje krahinore, po që u ka përgjithësuar në gjuhë.

ose «o, a, ja»; ose-ose «o-o, a-a, ja-ja». Mungon te G. Meyeri. Është një përngjitje, një jukstapozicion i o se, sh. dhe Weigand 64.

Mënyra, dhe gjer diku edhe koha, e formimit të kësaj lidhëze vihet re mirë te Buzuku: *Zot, kur na të pām se ti ishñjë unëtë, e na të dhām me ngranë; o se ti klë eççim, e na tÿ dhām me pītë?* «Domine, quando te vidimus esurientem, et pavimus te: sitientem, et dedimus tibi potum?»; *o na të jemi ngushulluom për të ngushulluomit taj e për të nfalët; ose na të jemi bām me ditunë për të bamit ditunë taj e të nfalët* «sive exhortamur, pro vestra exhortatione» (XLIII/2, Mateu 25,37; LXXXIII/2 = CIII/2, Korintasit II 1,6). Aty shihet se në kohë të këtij autori, ose të pakën në ndjenjën gjuhësore të tij, përngjitja e dy lidhëzave *o se* në një lidhëz të re nuk u kish kryer. Prandaj ai shkruan dy fjalë, *o se*, dhe mënyrën e tij të shkrimit do ta mbajë pjesërisht dhe transkribimi i sotmë. Përngjitja u bë në të parë në ato rasa ku *se-ja* kryesonte një fjali, duke u lidhur ajo drejtpërdrejt me predikatin e kësaj, sh. shembëllin e parë të Buzukut. Pastaj lidhëza e shtriu përdorimin e saj edhe përpara pjesëve të ndryshme të ligjëratës, para një emri, një përemri etj.: *njëri ose tjetri*, e me përsëritje *ose unë ose ti*. Me gjith'atë më e shpeshtë është para një fjalie; para një fjale përdorimi i saj është më i kufizuar. Formimi i *ose-së* i përgjan atij të *veçse-së*, sh. këtë fjalë.

P.

pa «para se», me pjesoren: *pa ardhur unë, pa dalë dielli*. Kundër mendimit të mëparmë (G. Meyer 317, Pedersen 173) Jokli (IF 37, 107v.) këtë e ndan nga parafjala *pa* dhe e lidh me *parë*; *pa nga pari* **parj*, me ndrim *rj*: *j* si te *prej pej*, e me rënie të *-j-së* fundore si te *pe* për *prej*. Pranuar me rezervë te Walde-Pokorny II 33, Walde-Hofmann II 351, Pokorny I 812.

Fjalë e mbarë e gjuhës. Me gjithë se te De Rada ka një herë (Milosaat XIII 16) *Paar garaksur* «pa aguar dita», prapsepapë mendimi që kjo lidhëz etimologjiksht është një me parafjalën *pa*, mbetet i drejtë. Në të mirë të këtij mendimi flet sëpari rrethana që fjalitë e ndërtuara me *pa* e me ndihmë të pjesores nuk janë të gjitha kohore, po ka shumë sosh që shprehin një mohim: *mbeta pa shkuar*; *s'i la gjë pa thënë*. Shprehin mohim edhe ato fjali që piqen në ndërtim me fjalitë kohore me *pa*: *pa qenë ai puna nuk bëhet* «po mos jetë ai p.n.b». Identitetin sintaktik dhe gjer diku edhe kuptimor të këtyre dy lloje fjalish e tregojnë rasa të tilla si këto: *pa të thënë unë mos shko*, që mund të merret si «në qoftë se s'të thom unë mos shko», po edhe «para se të të kem thënë unë mos shko», kuptimi i përbashkët «sa kohë që s'të thom unë mos shko»; ose *pa vaturë mesi dite* (këngë) = 1! «në një kohë kur s'kish ardhur dreka», 2. «para se të bëhej drekë», kuptimisht të dyja të bara-

barta. Kështu ura që çon nga mohimi i një veprimi ose i një gjendjeje te caktimi kohësor nuk mungon, as në ndërtimin sintaktik as në mendimin logjik. Prej gjuhësh së tjera khs. lit. *net* «nuk», po edhe «gjer, gjersa» e «para se» (Fraenkel 489, më parë në IF 43,297). Barazimi i *përpa* «pa», në fjali si *përpa të thanë unë*, me *përpara* nuk shkon, sepse *përpa* nuk është veçse *për pa*, pra lidhëza *pa* përforcuar me *për*; khs. në *qoftë e për në qoftë*, në fund të fundit edhe *tej e përtej*, *jashta e përjashta*, *pjeti e përpyeti*.

pagëtyrë f. «shpërblim, pagë». Fjalë sot e vjetëruar, del në literaturën e vjetër: Buzuku (LXI/2, Isaia 54, 17; LXXXIV/2 = CIV/2, Urta 5,16) *Këjo anshtë pagëtyra e sherbëtorëvet Tinëzot* «Haec est hereditas servorum Domini»; e *ndaj Tenëzonë anshtë pagëtyra e tyne* «et apud Dominum est merces eorum». Budi (DC 26) e *aqë sã mã tepërë mirë të banjë e të vepëronjë nierë mbë këtë jetë, aqë mã të madhe, e të plotë pagëturë shpëren prej Sinëzot se kã me pasunë*; edhe 198a, SC 124 etj. Nuk është një latino-romane **pagatūra*, më sa është *detyrë* një **debitūra*; po është një zgjerim i *pagë-s* me sufiksin *-tyrë* nga lat. *-tūra*, hyrë nëpërmes disa emrash si *fytyrë*, *kreatyrë*, *natyrë*; ose një postverbal i *paguoj*, *paguaj* po me këtë formant. Gjithsesi formim i brendshëm i gjuhës. Sh. tani Bul. i Univ. Shtet. të Tiranës. Ser. Shk. Shoq. 4 (1961) 181, *Revue de Linguistique* VII 1 195, Xhuvani-Çabej Prapashtesat 94.

pagëzój; **pagëzim** m. «të pagëzuarit; vendi ku pagëzojnë»; **pagëzór** m., **pagëzimtár** m. Bashkë me rum. *boteza*, it. *battezzare* etj. nga lat. *baptizare*; sh. G. Meyer 317, Alb. Studien IV 25, Pedersen KZ 33,538, Meyer-Lübke Gröbers Grundriss I² 1055, Puşcariu EW 212, Philippide II 632, Tagliavini 212v. Vështirësitë ku ndesh kjo etimologji përpiqet t'i mënjanojë G. Meyeri. Pas Meyer-Lübkes *pagëzój* nuk është zhvilluar nga *baptizare* me rrugë thjesht fonetike; në Mitt. d. Rum. Inst. Wien I 31 ai mendon për një ndërmjetësim të dalmatishtes.

Fjalë e mbarë gjuhës. Te Buzuku vetëm verbi: *Kjo anshtë mëndy-rë si pagezonënë djelmhtë* (XXIIIb). Për «pagëzim» ky autor ka *bagëm*, për «pagëzor» ka italianizmin *Batistë* (*Gjon Batista*). Ashtu si te *bagëm*, edhe te *pagëzój* ka vështirësi të rendit fonetik. Duket se këto dy fjalë, fjalë burimesh së ndryshme, kanë ndikuar në shqipen njëra më tjetrën. Andej rrjedhin pjesërisht dhe ndryshimet që kanë pësuar të dyja fjalët. Edhe të tjera huazime latine janë shndruar mjaft në gjuhën shqipe; khs. *ndëshkój*. Sh. tani dhe vrejttjet tona në *Revue de Linguistique* VII 1 183.

pajandër f. «tra që i vihet murit për mbështetje, maxhallëk». Mungon te G. Meyeri; e ka sëpari Junggu me Bashkimin, për «sorta di leva, sostegno di legno». Nga turq. *payanda* «mbështetëse muresh, tra etj.» (prej persishtes), që ka hyrë dhe në bullgarishten e rumanishten. Khs. për këto gjuhë Lokotsch 1611, Mladenov 414, Dict. li. rom. moderne 577. Në shqipen fjala ka marrë sufiksin *-ër*. Te Gazulli *pagjândërr pazhândërr*, me fortim të *j-së* në *gj* e me ndrim të kësaj në *zh*, dhe me sufiks deminutiv *-ërr*. Për *-ër* e *-ërr* sh. Xhuvani-Çabej, Prapashtesat 41v.

pajt, **paj** «në saje të». Fjalë e arbërishtes së Siqelisë (Piana dei Greci), e paspieguar te G. Meyeri 318.

Te fjala e t'in Zoti (II Nr. 21, Mateu 9,34; II 33 f. 1, Marku 8,35; II 33 f. 3) *Pajë të parit të diajëvet ti përze diajit; do të sbiërenjë shpirtin e tij pajë të meje; Perëndia i bekoj shpin pajt të Josefít*. Te Z

Skirói (Canti tradizionali 363) *Ndëjemë, o zot, për paj t'atij që të këtheu shëndenë* «Përdonami, o signore, in grazia di colui che ti ha ridonata la salute». Gjan të jetë për anë të «me anë të». Për një palatalizim të vjetër të *n-së* në *nj* e më tej në *j* khs. *ndaj*. Forma e parë e fjalës pas gjase është *paj*; *pajt* nga *paj* + të (artikulli i gjindores). Prej kësaj u arrit në *pajt të* (*pajt të Josefit*), duke u shtuar artikulli edhe një herë. Sot atje ndihet vetëm *pajt* me dhanore.

pajtoj «ndreq dy të meritur a dy armiq», intrans. «puqem, jam në harmoni» (për ngjyra etj.); *paqóy* «ujdis, rregulloj (një punë)», intrans. «ulem, bie fashë, qetësohem»: *më ka paque dhimba*; *paqoi stuhia*; *pajtis* «pajtoj», më fort intransitiv; *pajtim* m.; *shenjti pajtuer* m. G. Meyeri (f. 318v). këtë fjalë me variantet e saj (*paqonj, paqtonj, pajtonj, pajconj*) e me emrin *paqtim* «paq, pajtim» e vendon me të drejtë te *paq, bëj paq, jemi paq*. Te *pajtoj* «bie në ujdi, jap me qira; marr në shërbim, paguaj» ai gjen ndërkaq një përzjerje me lat. **pactare*, prej *pactum* «pakt, marrëveshje»; nga kjo **pactare* vjen sipas tij dhe *paqtonj*; e nga një **pactiare* *pajconj*. Te **pactare* e shpie *pajtoj* me të gjitha kuptimet dhe Meyer-Lübke (Gröbers Grundriss I² 1054); sh. edhe Weigand 65, Jokl LKU 324. Spiegimi i drejtë gjindet të Jokli, Revue Intern. d'Et. Balkaniques II 64: *pajtoj* me të gjitha kuptimet një denominativ i *paq*-it me sufiks -*toj* (*paqëtoj*), si *madhëtoj, vrapëtoj, shtektoj*, e me ndrim të grupit *qt* në *jt*.

Del që te Buzuku (LIX/2, Postcommunio): *e vepëra e tyne tÿ baf-të ti me klenë pajtuom* «et operatione sua tibi placidos esse perficiant». Budi DC 204a *Me gjudhÿt u pajtuo* «u muar vesh». Bardhi *Pacator Pajtues, Pacatus Pajtuem, Pacificatio Pajtim, Pacificator Pajtues, Pacificare Me pajtuem, poaty Pacificus M paq*. Për të tilla formime me -(ë)toj pranë atyre me -oj khs. dhe Jokl, Archivum Romanicum XXIV 16 e shënimet tona në Bul. për Shk. Shoq. 1 (1956) 134 shën. 1: *dëmtoj dëmoj, argëtoj argoj, falëtoj fajoj, copëtoj copoj* etj. Për zbutimin e *q-së* në *j* përpara *t-së* te *paqtoj: pajtoj* sh. dhe Bul. i Univ. Shtet. të Tiranës. Ser. Shk. Shoq. 1 (1958) 33vv. Për mendimin tonë edhe rrjedhojat e lat. *pactum* në gjuhët romane: sic. *appattari* «me pajtue», span. *pechar* «me pague tatime», port. *peitar* «me shkelë me pare» (te Meyer-Lübke REW 6138) janë formime të brendshme të këtyre gjuhëve: e para nga sic. *pattu*, e dyta nga span. *pecho* «tatim», e treta nga port. *peito* «tatim» (përkundrazi Rohlf, Diz. dial. d. tre Calabrie 100 it. e Kalabrisë *appattari* «essere uguale, confrontarsi» e shpie te një lat. **adpactare*). — Trajta *pajcoj* jo nga një lat. **pactiare*, po zgjerimi i *pajtoj* me -(ë)soj, *pajtësoj*; khs. *pakoj pakësoj, motoj motëson*. Trajta *palcoj* e tosk. jugore dhe e arbërishtes së Kalabrisë është trajtë «hiperkorekte», me *l* të tepëruar në dialekte që ruajnë *l*-në të pazbutur në *j*; khs. kal. *gal'tan* për *gajtan, kul'tonj* për *kujtoj*. Forma *pajtis* mbase pas *ujdis*.

pakë f. «seecila nga dy pjesët me dhjamë që dalin prej kurrizit e prej barkut të dërrit të therur». Mungon te G. Meyeri. Bashkimi «pezzo grande di lardo», Cordignano më saktë «Si dice delle due pezze laterali di lardo del porco»; poashtu Godini «Speckseite». Huazim gjermanik: gjerm. e lartë e vj. *bahho*, gjerm. e lartë e mesme *bache*, hol. e mesme *bake* «anë e dhjamit, pakë, përshutë», frank. *bakko* që rron në frgj.

e vj. *bacon* «pakë», për të cilën sh. Meyer-Lübke REW 889. Rruga e shtektimit të fjalës gjermanike gjer në shqipen nuk shihet mirë. Në *Revue de Linguistique* VII 1 179 kemi menduar për një ndërmjetësi romane perëndimore, khs. frgj. e vj. *bacon* te Meyer-Lübke REW 889, Veçse në italishten fjala nuk na del. Kështu burimi i saktë mbetet për të kërkuar. Reflektimi i *b*-së së huaj me *p* në gjuhën shqipe ka lidhje me mënyrën e artikulationit të eksploziveve të shqipes. Këto sipas Weigandit (Alb. Gram. 6v.), kur janë të zëshme, shqiptohen si lenes të pazëshme, e kur janë të pazëshme, shqiptohen pakëz të aspiruara. Khs. edhe Jokl LKU 74, 299v.

pakmós «të paktën, paksëpaku; poshtë-lart, afërsisht». Del që te Budi (SC 155): *ashtu ende për gjith ata qi vinjënë me ju rrëfyem, pakmos posikur të verbënitë ngjiturë ndore t verbënet me i hjekunë m perikullë*. Fjalë formuar në ngërthim të fjalisë, nga *pak* e *mos*.

Pāl m. Del që te Buzuku (LXXXIII/2 — LXXXIII/2, Apostujt 9,4) : *Pāl, Pāl, përse ti më bdon?* «Saule, Saule, quid me persequeris?» Budi (DC 172) *I shën Pāli i bëkuom me të madh arrësye e quon idolatrie*. Bogdani (I 9, 10) *Prashtu Palit nuk'i thonë biri i Pjetrit*. Nga lat. *Paulus*, me monoftongim *au.a*, si te *aurum* : *ār, laurus* : *lār, paucus*: *pak* etj., sh. Meyer-Lübke Gröbers Grundriss I² 1047 e shënimit tona në *Revue de Linguistique* VII 1 176. Emër personi nga një emër shenjti. Tosk. *Pavli Pavllo* nga gr. e re **Παῦλος**.

palaré f. «pjatë e përfushtë; pjatë me grurë të zier, që besimtarët ortodoksë çojnë në kishë në një përshpirtje, për ndjesë të së vdekurit». G. Meyerit 320 jep *polaré paralé* f., pas Rossit edhe *palár* m. «çanak i drunjtë, bludë», dhe e bashkon me serb. *poraliya* «çini» që jep Vuka për Grykë të Kotorit; të dyja i afron me it. *paiuolo* «kusi», ven. *parolo*, prov. *pariol* etj., prej lat. *pariolum* «kazan i vogël», pa u shprehur nëse mendon për një huazim latin apo roman të shqipes. Pas Pedersenit (KZ 33,538) nuk është marrë drejtpërdrejt prej latinishtes.

Fjalë e mbarë gjuhës. Bardhi Patina, piadena *Palarë e madhe, ò tepsì*. Bogdani (I 70, 2; II 95,8) *Esau tue shitunë parëbijëninë e ti për një palarë thier* «Esau vendendo la primogenitura per un piatto di lenticchie»; *aj anshtë, t'sillt kish për t'i dhanë nji felë bukë, ngjym ndë palarë* «era colui, à quale era per dare una fetta di pane bagnata nel piatto». Mitko 220 jep *palaré paralé* «**ξύλινο ταςί**». Në Opar fjala shënon qerin për të hulluar. Pokështu pas J. L Lazarit (Ed. e Re II Ser. III. Nr. XII, 1931, f. 364) në Tomor, në Myzeqe sipas tij «pjtatë prej balte për gjellë dhe për kërcëngëla (pemurina të thata)»; në Tiranë e në Dibër shënon qehnin me të cilin shtien bukët në furrë (Ed. e Re Ser. II, viti I = VII, Nr. 11, f. 432; poaty Ser. III, viti I = VII, Nr. 4, 1930, f. 157). Në Elbasan e në Berat pas Kristoforidhit *palaré* «**πινάκιον, πήλιον πιᾶτον ἢ φαρφουρένιον; τό πιᾶτον μέ τὰ κόλυβα**». Në Elbasan pas Weigandit «flache Schüssel»; atje ndihen edhe vargjet *Flutur flutur palaré, merr ment e bjer përdhé*. Junggu «vaso (di) forma simile al bacino», Bashkimi «scodella di legno»; Xanoni (Mateu 26, 23) *Njaj, qi po nyyen kashaten me mue n'palaré*, ku Buzuku ka *ndë mashtërkut*, Grigori ndë *xhanák(ë)*, e Kristoforidhi *ndë kupët*.

Gazulli dëshmon për Shkodër *palaré* «horizontalisht». Rrjedh nga gr. e mesme ἀπαλαρέα (gr. e re ἀπαλαριά) «kupë, çini, limbë», për të cilën sh. Triandaphyllidis 86, 97, 121; në dialektet e greq. së re (Pontos, Skyros, Kios etj.) ndër të tjera «στρογγύλος δίσκος τῆς ἐκκλησίας δι' ἀντίδωρον, κόλλυβα ἢ γλυκύσματα μνημοσύνων; τὰ εἰς τὰ μνημόσυνα προσφερόμενα ἐπί δίσκου γλυκύσματα ἢ κόλλυβα», 'Ιστορ. Λέξικον τῆς νέας ἑλληνικῆς II 335. Sikundër shihet, *palaré*-ja ka poato kuptime profane e kishtare të fjalës greke, nga e cila buron. Pra kemi të bëjmë me një huazim të kohës mesjetare bizantine, me një shprehje të kishës e të kuzinës. Për një vjetërsi mjaft të madhe të këtij huazimi dëshmon nga një anë përhapja e fjalës edhe në gegërishten (sh. për këtë kriter Thumb IF 26, 1vv., 7, Jokl IF 44, 38), nga ana tjetër afereza e *a*-së së fjalës greke. Fjalën *palarie* «enë ku mbledhin pare për nusen, cadeau de nocces pour la nouvelle mariée» të aromunishtes Capidani (Dacoromania VII 126v.) e spiegon si një huazim të ri prej *palaré*-së së shqipes, sh. dhe Papahagi 824. Afereza e *a*-së në fjalën aromune dëshmon për drejtësinë e këtij spjegimi. Në këto rrethana edhe serbokr. *poralija*, te Ristić-Kangrga 712 «ćanak, bljuda», formë edhe kjo pa vokal nistor, do të ketë shkuar prej shqipes. Baza e saj do të jetë trajta me meta-tezë *paralé*. Një lidhje edhe të rum. *palarie* «kapelë» me fjalën shqipe e kundërshton Capidani. Po e pranon Scribani (Arhiva XXX 88v.), tani rishmë edhe Dict. li. rom. moderne 594.

palaví f. «fjalë të ndyta; qelb»; *ka zanë shtati palavi* «ka zënë morra». Me të drejtë G. Meyeri 237 e vendon te *lai*, sh. dhe Xhuvani-Çabej, Bul. Shk. Shoq. 4(1956) 86. Del sëpari te Budi (DC 70, 177a, 183b, RR 9. 13, 330, SC 164. 396): *gjithë mkateshit e palavishi cë korpit helmuom; të pā ndōnjë palavī me duor të dēlira e të pāpērgjegjuna* «sine macula, et innocens manibus, et mundo corde»; *Me mkat gjithë palavuom; kund përziem e palavuom me farmēkutē ndōnjī mpkatī murtār*. Verbi *palavój* sot përdoret figurshëm, për «fëlliç gojën, flas palaví»; konkretisht për «fëlliç, ndyj» ka hyrë më fort *palavós*, formim me -os; edhe *palavós* «fëlliçqash, i ndytë». Forma primare është emri *palaví*. Kjo është substantivimi i participit *palá palaré*, zgjeruar me -i (**palái*) e pajisur me një -v- kundër hiatit. Nga *palaví* u formuan verbet *palavój* e *palavós* e mbiemri *palavós*.

palé, pjesëz që shpreh një urdhër a grishje, e që i prin një fjalie urdhërore a një pyetjeje të zhdrejtë: *palé të shohim një herë; të shofim palé a vjen*. G. Meyeri 319 e merr për një huazim nga sllavishtja: serbokr. *le* «vërtet, me gjith'atë» (pjesëz përforcuese në fjali negative), slloven. *le* «vetëm, veçse», çek. «por» etj. Si e vuri re dhe Kristoforidhi (f. 299), kjo pjesëz është leksikalizimi i fjalisë hortative *pa le*, me formën imperative të verbit *lë lā* e me adverbën *pa*. Është një nga fjalët e shuma që kanë lindur si jukstapozicione në ngërthim të fjalisë, si *druese, mbase, ose, shkllata* etj. Sh. Bul. për Shk. Shoq. 2 (1954) 47. Një formim analog është gjerm. *lasst* «leni» në fjali si *lasst uns hören* «le të dëgjojmë». Të tjera shembëlla te *le*. Sh. edhe *pam*.

palēhúar, -ori m. «vend i shkelur, i prishur, i shkatëruar, trohallë». Fjalë e tosk. jugore të Përmetit, që mungon te G. Meyeri. E ka Kristoforidhi f. 300, bashkë me spjegimin e drejtë nga gr. e re παλαιχώρ

(*παλαχοώρα*) «fshat i keq, fshat i humbur»; khs. dhe Bul. për Shk. Shoq. 2 (1954) 47. Një përkthim për gjysmë i fjalës greke, me marrje të pjesës së parë, është *palofshat*, edhe kjo e krahinave të Jugut.

palnje, panjë f. «Acer». Këtë emër druri G. Meyeri 332 e jep pas Mitkos si *pënjë panjë* e me kuptimin e papërcaktuar «një lloj druri që s'jep pemë», dhe mendon — me dyshim — për një burim nga serbokr. *panj* «trung, kërcu». Selisçevi nuk e përmend ndër elementet sllave të shqipes. Jokli (LKU 188vv.) jep për toskërishten pas S. R. Dines (f. 838) *panjë* e për gegërishten pas Junggut *pai* m. «acero» e pas Bashkimit *pálnie palnje pátnie* «specie di albero montano di legno bianco e duro le cui foglie s'assomigliano a quelle del platano», e për anët e Dibrës pas Puljevskit *pallum* për sllav. *javor* (panjë). Etimologjikisht e vendos fjalën te grupi lat. *palpāre* «me prekë lehtë, me le-dhatue» *palpitare* «përpëlitëm» *papilio* «flutur», isl. e vj. *falma* «prek, dridhem frike», gr. *πελσμαίζω* «lëkund, shkund, bëj të dridhet», duke u nisur për shqipen nga dejtë e lëndës së këtij druri si element emërtimi.

Fjalë e mbarë gjuhës, po me trajta të ndryshme nëpër dialekte. Gazulli jep *palnje* «Acer platanoides», Fjal. i gju. shqipe *panjë fletë-gjerë* «Acer pseudoplatanus». Sh. dhe Mitrushin 269vv. Në toskërishten zotëron *panjë*, në gegërishten *palnje palnjë*. Trajta e Junggut del dhe në Lumë si *pajë*, që jep Mitrushin. Për punë të etimologjisë ka rëndësi të konstatohet trajta bazë e fjalës. Variantet e sotme: *palnje, patnje, panjë* piqen te një e përbashkët **paltnje*, nga e cila kanë dalë me rrugë të ndryshme. Prej asaj ka rrjedhur jo vetëm — si vuri re Jokli — *patnje*, me rënie të likuidës në një grup tri konsonantesh, po edhe *palnje*, me rënie të *t*-së; prej *palnje* u zhvillua më tej *panja* e toskërishtes, duke u zhdukur *l*-ja, e prej *panjë*-s pastaj edhe (labërisht) *pënjë* (Kallarati i Kurveleshit *Vër e penjës, Lugu pënjës*), afërsisht ashtu si *mënjë* «shi i hollë, një rigë shi» nga *manja*; forma *pallun* (*pallën*) e Puljevskit për ne është sekundare. Në pikëpamje kuptimore për etimologjinë ka rëndësi kjo, që *panja* e rrapi janë drurë me fletë të gjera si pëllëmba e dorës e që prej këtej kanë marrë shpesh edhe emrin; khs. prej shqipes *panjë fletëgjerë*, veçanërisht prej katundit Acquaformosa të Kalabrisë *fjetgjër* «Platanus, rrap» (Rohifs AIS), me ndrimin e rregullt t'atjeshmin *fl: fj*. Ashtu dhe gr. *πλάτανος* «rrap» dihet se rrjedh nga *πλατύς* «i gjërë», veçse jo aq nga degët e hapëta që ka, si mendohet përgjithësisht, po pas mendimit tonë më fort nga fletët e gjera të tij, krejt ashtu si shq. *fletëgjerë, fjetgjër*. Në këto rrethana dhe për *palnje* do të mendohet një zhvillim kuptimor i këtillë. Baza e fjalës është *palt-*, zgjeruar me sufiks *-nje -një* si shumë emra drurësh e bimësh, si *dushnje, frashnje, ilnje, shelnje, ulnje, si leshnje, myshnjë* etj., sh. për këto Xhuvani-Çabej Prapashtesat 71. Kjo *palt-* e *palnje*-s afrohet me gr. *πλάτανος* «rrap» *πλατύς* «i gjërë», lit. *platus* «i gjërë», ind. e vj. *prtháh* «i gjërë, i hapët» etj. Shqipja me greqishten afrohen këtu në mënyrë të veçantë në zbatimin e kësaj rrënje për emërtim të dy drurëve botanikisht të afër, me gjithë se ky përdorim mund të ketë ndodhur në të dy gjuhët në mënyrë të pavarur. Në këto rrethana mund të mendohet që kjo rrënjë indoeuropiane, edhe në shqipen, ku çfaqet si *palt-*, ka qenë fjala që shënonte kuptimin e përgjithshëm të së gjërit, po që me kohë i la vendin fjalës

gjanë gjërë, duke gjëllitur vetëm si emër druri. — Rum. *paltin* «*Acer pseudoplatanus*» largohet në formën e saj nga lat. *platanus*, prej së cilës e nxjerrin. Prandaj do të pranojmë me Joklin që aty ka ndikuar fjala e shqipes, aq më shumë kurqë — sikundër vren ky dijetar — rumanishtja ka mjaft emra durësh (e bimësh) të burimit shqiptar: sh. *breëh*, *bung*, *kulpër kurpën*, *madërgonë*, *mështekër mështekën*, *modhull*. Sh. tani Rev. Shkencore e Inst. Pedag. dyvjeçar të Shkodrës 1(1964) 26,30.

paluze f. «*pelte*». Mungon nëpër fjalorë; e ka të folët e Dibrës. Nga turq. *paluze*, kjo prej persishtes. Fjala turke ka hyrë dhe në serbokroatishten (*paluza*), sh. Skok Slavia XV 484. Duket të jetë e një burimi me sinonimin *pelte*, sh. Lokotsch 1645.

pall «*pëllet gomari*»; *pëllás pëllét*; *shpall*, neologjizëm *shpallje* fq.: *përpáll* «*shpall botërisht, përhap në botë një gjë të fshehtë*». Te G. Meyeri 319 e paspieguar, e f. 320 gabimisht me *l* palatale, prandaj bashkuar pa të drejtë me *palë*. E afër me lat. *palam* «*botërisht, haptas*», rus. e vj. *polyj* «*i hapët, i lirë*» etj., sh. Jokl Studien 83v., Archiv. Romanicum XXIV 16, më parë Kamarda I 240. Pranuar te Walde-Pokorny II 61, Walde-Hofmann II 237, Pokorny I 806, Vasmer REW 391.

Del sëpari te Bardhi: *Mugire Me pállunë*, *Mugitus Pállmë*, *Mugitus bovis Pállme e kaut*, *Reboare Me pállunë*, *Remugire Me pállunë kundrë*, *Rugire Me pállunë, ò me bām zanë possi luā*. Bogdani (I 73,9: II 2,6) *mbassi u përpáll Ungjilli shenjt* «*dopo la publicatione dell' Evangelio*»; *Këto Profetë kjenë përpállunë ndëpër gjithë shekullit* «*Queste Profezie furono divulgate per tutto il Mondo*». Zgjatimi i vokalit ka rrjedhur nga prirja për të ja ngjarë pallmës së shtazëve. Te ky grup fjalësh vendojmë ne dhe tokar. *pal-* «*vanter, célebrer*», të cilën Meillet (Journ. asiat. I 457) e pas tij shumë dijetarë (si Benveniste Hirt-Festschrift II 236, sh. edhe Fraenkel 32) pa të drejtë e afrojnë me lit. *balsam* «*zë, tingull, zhurmë*» *bylā* «*bisedë*», prus. *billit* «*thom, flas*» etj. E vë në dyshim me të drejtë dhe Lidén Armeniaca 49.

pam «*pa, palé*». Del vetëm te Buzuku, p.sh. (LXIII/2, Eksodi 16, 4; LX/2 = LXX/2, Gjenezja 8,8) *përse u ata të tentonj e u të shoh pam a të ecnjënë ndë ligjet të mi, o jo* «*ut tentem eum, utrum ambulat in lege mea, an non*»; *E dërgoi pëllumnë mbas korbis, me pām pam a ishnë nlem ujënatë përmbi dhët* «*Emisit quoque columbam post eum, ut videret si iam cessassent aquae super faciem terrae*». Si shumë ndajfolje e lidhëza (*druese, mbase, shklata, ndonëse, ose, palé, pondë* etj.) është edhe kjo një fjalë përftuar brenda sandhit, në ngërthim të fjalisë. Është një jukstapozicion *pa + m* = lidhëza *pa +* forma e eliduar e përemrit personal *më*. Ka dalë prej fjalish si (XLIX/2, Gjenezja 27,21) *Pa m u afëro* «*Accede huc*», duke u përgjithësuar, si në fjalitë fill pas asaj *se duo të të përkas, o biri em, pam a je biri em Ezau, a jo* «*ut tangam te, filli mi, et probem utrum tu sis filius meus Esau, an non*». Variante krahinore e *pa-së*, që s'pat fat as në gjuhën popullore as në literaturë. Në vend të saj më fort e thjeshta *pa ose* — në Veri — *palé*.

pameta «përsëri». Dëshmohet dhe për toskërishten, po i përket kryesisht arbërishtes së Italisë. Është një jukstapozicion *pa+meta* «përsëri» nga gr. e re *παρά* «pas»; sh. Kamarda I 310, G. Meyer 270, 317 (*te meta, pa*), Lambertz KZ 53,295 me literaturë (Gius. de Rada, Gram. alb. 90). E ka dhe Siqelia. Mitko ka *pámëta*, me theks mbi pjesën e parë të kompozitit e me shurdhim të e-së në ë. Edhe *gjene* «përsëri» nga turq. *gene* ka formuar varianten me *pa-* *pagjene*, me kuptimin «fundi i fundit, tekembramja» (në fjali adversative).

pandërë f. «një copë pëlhurë e qëndisur, një këmbë e gjatë e e gjërë, të cilën e vënë gratë në mes e përmbi prehër». Këtë fjalë të shqipes së Kalabrisë G. Meyeri 320 e spiegon nga një lat. **pant(ic)ārium*, prej *pantex* «bark, mullë». Sh. dhe Philippide II 672.

Etimologji që nuk qëndron, sh. Revue de Linguistique VII 1^o 193. Një lat. **pant(ic)ārium* nuk del me një të tillë kuptim në asnjë gjuhë romane; rum. *pîntecaraie* do të thotë «të prera në bark», sic. *pantaciari* «të hequr bark». Edhe fonetikiqisht spjegimi është i vështirë. Nuk ka si veçohet kjo fjalë nga *vanderë* «përparje, futë» e arbërishtes së Siqelisë, të cilën G. Meyeri 463, nga sa duket, jo me të drejtë, e spiegon nga it. dialektore *ventrera* (sh. *vanderë*). Te të dyja këto fjalë kemi të bëjmë pas gjase me reflekse dialektore të it. *bandiera* «flamur». Nga ato, *vandera* e dialekteve arbëreshe t'Italisë do ta ketë burimin në it. dialektore *vandera* për it. *bandiera bandera*; *pandërë* nga it. *bandera*, me ndrim të konsonantit nistor. Kjo do të ketë lidhje me mënyrën e shqiptimit të okluziveve në shqipen. Khs. për këtë Weigand Gram. 6v., Jokl LKU 74, 299v. Edhe në aromunishten flamurit i thonë *pandera*, sh. Papahagi 814.

pandispanjë f. «lloj revanie e thatë, pa sherbet». Mungon nepër fjalorë. Nga it. *pan di Spagna*, mbase nëpërmjet të turq. *pandispanya*. Khs. për fjalën italiane E. Li Gotti, Pan di Spagna (Lingua Nostra XII, 1951, f. 99v.). Prej këndeje rrjedh pas gjase dhe *panikpán* m. «ëmbëlsirë me miell misri, sheqer e ve» e jo prej it. *pane di panico* «bukë meli», si mendon Weigandi 65; aty ka asimilim *nd : n*. Një tjetër huazim nga it. *pane* është *panikotë* me shqipen e Greqisë, për të cilën sh. G. Meyer 321.

panë f. «cipë, lëmazë (e qumështit, e qepës, e vesë etj.); perde që të vesh sytë». Mungon nëpër fjalorë. Nga it. *panna*, po si një fjalë e tosk. jugore, pas gjase nëpërmes të greq. së re: *πάνα πάντα* e *πανάδα* «katarakt në sy». Këtë G. Meyeri (Ngri. Studien III 51) e nxjerr nga lat. *pannus* «cohë, shajak». Fjalën *pana* «leckë për të fshirë vatrën; perde që të vesh sytë» e ka dhe aromunishtja, sh. Papahagi 814.

paqe, f., *paq* m.; *paqó* «ujdis, rregulloj (një punë)», intrans. «ulem, bie fashë, qetësohem», *pajtó* «ndreq dy të meritur a dy armiq, intrans. «puqem, jam në harmoni» (për ngjyra etj.), *pajtím* m., *shejti pajtuer*: *paqtónj*, *paqësó*j, *pajcónj*, *palcój* «paj'toj», «*pajtís* «pajtoj», më fort intransitiv. Nga lat. *pācem*: G. Meyer 318, AS IV 47, V 97, Meyer-Lübke Gr Gr I² 1051, Puşcariu EW 1235, Weigand 65. Sh. dhe *pajtoj*.

Fjalë e mbarë gjuhës. Paraqitet si ambigjene që me autorët e vjetër. Buzuku (LXXIII—LXXXIII, Korintasit II 13, 11; LXI—LXXI, Gjenezë 8,21; LXIV/2=LXXIV/2, Luka 24,36) *kini paq*, e *Zotynë i karitatit e i paqsë të jetë me jū* «pacem habete, et Deus dilectionis et pacis

erit vobiscum»; *E Zotynë pat ndë erë të bukurë atë sakrificio për shenj n paqi* «*Odoratusque est Dominus odorem suavitatis*»; *Paqi me jū* «*Pax vobis*». Bardhi *Pax Paq*, *Pacator Pacificator Pajtuës*, *Pacatus Pajtuem*, *Pacificatio Pajtim*, *Pacificare Me pajtiem*, *Pacificus Mpaq*, *Bogdani* (I 126,8) e *banj me shtëpi të Judësë paq të ri, jo si pajnë qi bana me Plejt tāj aso ditëje* «*et feriam Domus Iudae foedus novum, non secundum pactum quod pepigi cum Patribus vestris in die illa*». Për trajtën *paqe* Jokli (IF 36, 161v.) sheh dy mundësi spjegimi; ose *-e-ja ka* hyrë në njëjës nga shumësi; ose në përpjestimin *nusja: nuse = shelqja: x mundi e u* formua lehtë trajta *shelqe, paqe* etj. Si e kemi shtjelluar në Li. Posn. VIII 114 vv., *Revue de Ling. VII 1 171v.*, femëroret e të tretit lakim të latinishtes si *gens gentis, pax pacis* kanë ruajtur gjininë e tyre në shqipen, duke pësuar apokopë të rregullt të *e-së* fundore, duke dhënë pra *gjind gjindja, paq paq(j)a* etj. Këto lloj femëroresh kaluan pastaj pjesërisht në mashkulloret (*paq paqi*), pjesërisht — në analogji me femëroret me *-e* si *nuse nuseja* — në femërore me *-e* (*paqe paqja*). Kështu u arrit në dy trajtat e sotme të fjalës. Në pranimin e një analogjie piquemi pra gjer diku me mendimin e Joklit. — Nga rrjedhojat verbale që u përmendën më sipër, *pajcoj* ka dalë nga *paqësoj*, me ndrim të *q-së* në *j* (sh. BUST 1, 1958, 33vv.) *pajsoj*, e me fortim të *s-së* në *c*. Trajta *palcoj* e tosk. jugore (Gjirokastra me rrethe) do gjykuar ashtu si *gal'tan* për *gajtan*, *kul'tonj* për *kujtonj*, *val'tonj* për *vajtonj* në arbërishten e Kalabrisë, për të cilat pas Pedersenit (KZ 33,550) e Joklit (IF 37,107) sh. dhe shënimit tonë në BUST 1 (1958) 51. Neologjizma janë *paqedashës* e *paqësor*, ky edhe si term gjeografik (*Oqeani Paqësor*).

paqyll m. «*njeri i trashë nga mendja, i metë*». E ka Ed. e Re (te Manni) e Fjal. i gju. shqipe. Gjan të jetë një formim me *-qyll*, trajtë metafonike e *qull-it*, kompozuar me *po-*, që në gegërishten mund të ketë hapur *o-në* në *a*. Fjala *qull*, bashkë me rrjedhojat e saj *qullac* e *qullët*, përdoret për një njeri të mbetur, të mefshtë e pa energji.

paramanë f. «*lloj karfice, për petka e për flokë*». Fjalë e tosk. jugore, që mungon te G. Meyeri. Leotti *paremane* «*spilla, spillo*». Fjal. i gju. shqipe *paramanë* «*një lloj karfice petkash*». Lambertzi (Li. Posn. VII 88,104) jep prej Gjirokastrë *paramandë* «*karficë flokësh*», me *-d-* zhvilluar si tingull homorganig pas *n-së*, bashkë me etimologjinë e fjalës: gr. e re *παράμύνα*. «*lloj karfice*». Arom. *paramana* Papahagi 817 e afron me fjalën shqipe, po edhe me it. *paramano*, që nuk na duket të hyjë këtu.

paravësh m. «*shuplakë, shpullë*». Mungon te G. Meyeri. E ka sëpari Junggu si *paravësh* mashk. e Bashkimi si fem. *paraveshë*, me shprehjen me *hjekë paraveshë*, femërore që mund të spjegohet nga plurali *paraveshë-t*. Sikundër shënohet dhe te Xhuvani-Çabej (Bul. për Shk. Shoq. 4, 1956, f. 87), është një kompozit i *vesh-it* me *para-*, ashtu si *paravithë, paraderë*. Për kuptimin khs. gjerm. *Ohrfeige* «*shuplakë*»: *Ohr* «*vesh*», frgj. e vj. e piem. *orillon*, «*shuplakë, shpullë*» (Meyer-Lübke REW 739), gr. *παρήϊον παρειά* «*faqe*» («*vend para veshëve*»).

parmendë, parmëndë f. Spjegimi i G. Meyerit (f. 322) nga një lat. **peraramentum*, prej *perarare* që dëshmohet në latinishten mesjetare të Gjermanisë, pëlqehet te Jokli IF 36,155, LKU 136; poashtu dhe ne në Bul. për Shk. Shoq. 1 (1956) 133.

Fjalë e mbarë gjuhës, në kundërshtim me *plug-un* që ka një përhapje krahinore. Bardhi nuk e ka, ai «aratrum» e jep me *umbi, plori*. Te Nopcsa 119 *permen*. Lab. (Brataj i Vlorës) *parëmëndë*, në Siqefi *pëlorë* i *parëmëndës* (Z. Skirõi, Rapsodie albanesi 9) bashkë me *poromed* në Rekë të Dibrës dëshmojnë për ekzistencën e një ë-je në silabë të dytë, sh. Bul. për Shk. Shoq. 1 (1956) 133. Fjala në viset jugore e në kolonitë e Italisë shënon dhe hyllësinë e Harushës së madhe; poashtu gr. e re *λάετρι* «parmendë» në dialektet e Maqedonisë përdoret dhe për këtë hyllësi, sh. *Ἰστορ. Λέξικον τῆς νέας ἑλληνικῆς* I 431. Ky emërtim duhet të jetë dhe në Veri, ku *poromed* e Rekës pas Puljevskit është edhe ajo një emër hyllësie. — Spiegimi nga një lat. **peraramentum* nuk mund të mbahet. Kur latinishtja nuk ka pasur as verbin **perarare*, është e pamundur që bash në shqipen të jetë ruajtur një **peraramentum*. Sikundër që *almise* «vegla bujqësore» ka dalë nga një fjalë me kuptim «armatim, pajisje», edhe *parmendë* buron prej një fjale latine me një kuptim të këtij lloji. Ose e afër me it. *paramento* frgj. *parement* prov. *paramen* etj. «stoli», mbase prej një lat. **paramentum*, sh. *Revue de Linguistique* VII 1 196. Ose nga lat. *apparamentum* «gatitje; pajisje, vegël» (?) që dëshmohet në CIL II 1567, te Ernout-Meillet 735. Në cdo rasë të *parmendë* vihet re ngushtimi i një kuptimi më të përgjithshëm në drejtim të një specializimi në fushë të bujqësisë. Përveç kësaj edhe kjo është një nga ato fjalë ku shqipja afrohet me gjuhët romane perëndimore, duke mbetur jashtë rumanishtia. Për këto sh. poaty f. 174v. Fonetikisht **paramentum* ose *apparamentum* dha në shqipen më parë *parëmëndë*. *parëmëndë-n* që u tha më sipër. — Kjo trajtë më e vjetër e shqipes ruhet dhe në *paramanda-paramenda* të aromunishtes, sh. për këtë Papahagi 817. It. *paramento* del te Budi RR 10: *E ashtu ende fort mirë të venë roe Prifti qi paramentetë, e petëkatë, e gjithë të tjeratë enë... të jënë gjithë të tana e t'ungjina e të mpastra, e të dëlira si duhetë*.

parzëm, parmëz f. «kraharor, gjoks». Për këtë fjalë të gegërishtes G. Meyeri 322 jep pas Rossit trajtën *parmzë*, prej shqipes (kelmendase) të dikurshme të Sirmies pluralin *parmza-t* e prej Borgo Erizzos në Dalmaci *parzma-t*, dhe e spiegon fjalën nga serbokr. *prsi prsa* «gjoks» = sllav. e vj. kishtarë *prъsi*. Edhe Weigandi (XVI-XVII. Jahresber. d. Rum Inst. Leipzig 233) është i këtij mendimi. Vasmeri (Studien I 48) nisat nga *parmzë*, dhe aty anon të shohë deminutivin e një primitivi të rindërtuar **parmë* me kuptimin «shqyt, mburojë», e te kjo vetë një huazim eventual nga lat. *parma* «shqyt i shkurtër e rrotullar». Kundër çdo lidhjeje me sllav. *prsi* sillet edhe Skoku (*Revue Intern. d. Et. Balk.* I 298), kryesisht për punë të trajtave *parxë* e *parmë* që ka Godini. Meqë në këtë drejtim shprehet dhe Rešetari, e meqë dhe Selišćevi nuk e numëron fjalën ndër huazimet sllave të shqipes, Tagliavini 215v. sheh të mundshme një lidhje afërie të fjalës shqipe me fjalën sllave.

Është e mbarë gjuhës, me qenë se e ka dhe të folët e Semanit të Fierit, si *parmez* e me kuptimin «clavicula, hekësi i pulës (J. Stefi. Bul. i Univ. Shtet. të Tiranës. Seria Shk. Shoq. 4, 1961, f. 143). Del që te Buzuku (XXIV/2, XXV/2a): *me të ftofëtat të Tinëzot tue i dëlirunë parmëzatë* «divino fonte purgatum pectus» (Rit. Romanum Tit. II cap. 4); *E u tÿ të lyenj me voj... mbë parmëzat e ndë të dÿ krahët*. Kështu, si shumë, e përdor sipas Gazullit dhe Malsia e Madhe (*më dhambin parmëzat*),

Sirmia dikur (*parmza-t*) e Borgo Erizzo (*parzma-t*); për një të tillë përdorim të krahërorit dhe në serbokroatishten (*grudi, prsi*) etj. sh. vrejtit tona në Li. Posn. VII 183v.; si njëjës përkundrazi *parmëza e fanelës* «busto, Rumpf, Oberleib» te Gazulli. Veriu njeh dhe formën *parsem*, si në Gurzi, te Junggu, Bashkimi e Përparimi (VII, 1914, f. 57): *plumja n'parsem*. Rrjedhojat *parzma* e *parzmore* «pancir» (te Logoreci, Leotti, Cordignano s.v. *corazza* etj.) nuk dëshmojnë për të folët popullor, duket të jenë neologjizma, sajuar në qarqet e Shkodrës. Me *parzëm të hekuritë djelmëni*ja të mprote te Mjedja (Lissus IV varg 14) është një përdorim metaforik i poetit. — Për etimologjinë e fjalës ka rëndësi të dihet se cila nga dy trajtat e saj është më e para. Nuk ka dyshim se sot *parzëm parzma parzmat* është më e shpeshta, po rrethana që Buzuku bashkë me disa ligjërimi marginale konservative ka *parmëza*, flet në parim në të mirë të parësisë së kësaj trajte, të cilën pamë se e ka dhe toskërishtja. Ky mendim është më afër mendsh, kur të kemi parasyshtë rasa si *gjymse gjymse*, ku shihet prirja për metatezën e grupit *ms* në gjuhën shqipe. Duke u nisur nga *parmëzë*, kjo paraqitet si deminutivi i një *parmë*, po kjo nuk është gjë tjetër veçse forma e substantivuar e mbiemrit *i parmë*, zgjerim me *-më* i *i parë* bash në cilësime të pjesëve të trupit: *këmbët e parme*, *dhëmbët e parmë* (Çekrezi 79). Kështu gjoksi i ka dy emërtime në shqipen: një prej *krah-ut* (*krahënuer krahëror*) e një si pjesë e përparme e trungut të njeriut. Për këtë khs. ndër të tjera frgj. e vj. *devant* «krahëror», edhe sot *sur le devant du cheval*. Trajta *parmë* ekziston me të vërtetë, po vetëm si *parmat e fytit* pl. «secila nga dy arteret e mëdha që shpien gjakun prej zemrës në kokë» (Gazulli), khs. për këtë kuptim gr. *ἀντιάς* «gjëndër e qafës»: *ἀντί* «përballë, përpara». Jo nga *parmë*, po drejtpërdrejt nga *parë* është formuar *parzat e trikos* «dy krahët e para të trikos» në Dibër e *parzë* «parzëm» te Godini, në qoftë se kjo ekziston me të vërtetë. Nga *parzat* kuptohet dhe përdorimi i *parzëm-s* si plural (*parmëzatë parzmat parzmat*); me të shënohet krahu i djath-të e i majti i krahërorit. — Që baza e fjalës nuk është lat. *parma*, është theksuar dhe në Revue de Linguistique VII 1 193.

parríz m. «parajsë». G. Meyeri (f. 322) vuri re me të drejtë që *parajsë* e *paradhís* vijnë prej gr. së re *παράδεισος*, po *parriz* e spiegon nga it. *paradiso*. Ashtu edhe Helbigu 72. Me të drejtë Tagliavini 214v. kthehet te mendimi i Miklosichit (Alb. Forsch. II 593), i cili burimin e kësaj e gjen te lat. *paradísus*.

Del që te Buzuku (XL, Korintasit II 12,4): *aj kle grabitunë djerie ndë Paris* «quoniam raptus est in Paradisum». Budi (DC 187 b) *Po m Parrizi cë tî Jashtë e qiti e e vdoj*; Bardhi *Paradisus Paris*; Bogdani (II 161,27) *se korpënatë ndë Parisit kanë me pasunë një ërë fort të bukurë* «che li corpi nel Paradiso haveranno un odore bellissimo». Si e kemi shtjelluar dhe në Revue de Linguistique VII 1 183, dy trajtat e ndryshme të fjalës, me theksimet e tyre të ndryshmet, rrjedhin prej dy burimesh së ndryshme: geg. *parís parríz* prej lat. *paradísus*, tosk. *parajsë* prej gr. *παράδεισος*. Nga trajtat e burimit grek, *parajsë* paraqitet si më e vjetër, mbase huazim nga greq. e mesme; *paradhís* më e re, mbase fjalë librash. Në arbërishten e Italisë ruhet mashk. *parrájs*, te Matranga (f. 15) *ndë parrájsit*, ashtu dhe te Kamarda I 98 e te Skirói Canti trad. 64; në Molize me metatezë *pariás*, Lambertz KZ 53,295. Që

parriz paris vjen nga lat. *paradīsus*, e jo nga italishtja, këtë e dëshmon më së miri zhdukja e *-d-*së intervokalike. Te *paradīsus*: *parriz paris* kemi sibilantin e zëshëm latin (*z*) që dha në shqipen *z(s)*, pran-daj ai tingull nuk u kthye në *sh*. Në gjithë trajtat e shqipes *r-*ja e fortë rrjedh prej një geminacioni ekspresiv. Zgjatimi i *i-*së te *pa-rriz* rrjedh nga kontraksioni që u bë në lat. *paradīsus* në shqipen te silaba ku ra *-d-*ja, po mund të reflektojë dhe *i-*në e gjatë latine.

pastër f., emër peshku, pas Cordignanos «Pleuronectes platessa italicus», pas Gazullit *pastër deti* «yll deti». Nga it. (*pesce*) *passera* «Pleuronectes», me *-t-* si tingull kalimi në grupin *sr*, si te *nesër*: *nestrë. pastër deti* është përkthimi i it. *passera di mare*.

pashnik m. «mbulesë e hollë; peshqir; pështjellë e të vdekurit, savan». G. Meyerit 323 e jep pas Bardhit e pas Rossit si *pasnik* dhe e spiegon nga turq. *bashlik* «mbulesë e kresë, kapuç».

Fjala turke ka dhënë në shqipen *bashllëk*, ashtu si ka dhënë forma të afra në gjuhët e tjera të Europës, për të cilat sh. Miklosich (TEL I 257vv., Nachträge II 82 vv.), Lokotsch 260, Vasmer REW I 65. *pashnik* dallohet nga *bashllëk* si nga kuptimi si nga forma. Për formën do shënuar se fjalët turke, si huazime relativisht të reja që janë, nuk kanë pësuar dhe aq ndryshime formale në gjuhët ballkanike, duke përfshirë aty edhe shqipen. Te Bardhi *pasnik* «sudarium» mund të lexohet *pashnik* e *pashnik*, meqë germa *s* tek ai vlen për *s* e për *sh* (Cauda Bist, Caverna Spelle). Që dhe aty fjala do lexuar pas gjase me *sh*, këtë e tregon *ky anshtë Pashniku i Gedeonit* «Questo è il Velo di Gedeone» e Bogdanit (II 14,9. Fjala është përdorur gabim te ky vend i autorit: duhej it. *Vello* e shqip *Bashkë*, sikundër e ka drejt me një tjetër vend, I 68,19, *Bashka e Gedeonit* «Vellus Gedeonis»). Poashtu me *-sh-* e ka fjalën dhe pjesa më e madhe e traditës së fjalës në geg. veriore: *Bashkimi-pashnik* «sudario, sorta di velo, grasso d'animali che involge gli intestini dei medesimi»; pokështu Cordignano, i cili jep dhe variantet me *-th* e me *-e* *pashnikth* m. e *pashnike* f. Godini «Handtuch», Manni «peshqir duarsh e peshqir banje». Në Orosh *pashnék* «peshqir duarsh», me mird. e për *i*. — Nuk mund të ndahet kjo fjalë nga *pacanik*, pl. *pacanike* «grembiale delle montanare» (Jungg, Cordignano), «sorta di grembiale» (Bashkimi), pra «futë, përparse». Kjo gjan të jetë **parcanik* e kështu etimologjikisht identike me *përparcë*, veçse zgjerim me *-nik* i trajtës së thjeshtë *parcë* për *përparcë*. Në këto rrethana *pashnik* ka dalë nga **parsnik*, kjo si *par-s-nik* nga *parë para*, poashtu si *përparje përparse përparcë* nga *përpara*. Për ndrimin *rs : sh* (ose *s : sh* me rënie të *r-*së aty pranë) khs. *vërsnik* «moshatar», në Gjirokastër *vëshnik*. Trajta *pasnik* e Junggut (ku mund të hynte edhe ajo e Bardhit) ka dalë nga **parsnik*.

pashtrák m. «taksë kullote; vendi i kullotës brenda kufive të një bajraku». Fjalë e geg. veriore (Mirditës) e e Kanunit të Lekë Duka-gjinit, e padalë në dritë në kohë të G. Meyerit. Bashkimi «mercede o multa per pascoli», poashtu Cordignano; Kanuni i Lekës (f. 143) «vend i përbashkët kullose mbrenda një flamuri; edhe: gjoba, qi merret për shpërdorim të pashtrakut të huej». Nga një lat. ballkanike **pastūrātīcum*, prej *pastūra* «kullotë», me sufiks *-āticum*, i shpeshtë sidomos në latinishten ballkanike, Jokl Glotta XXV 121 vv., Walde-Hofmann II 260.

Ka një përhapje më të madhe. Në Mat *poshtrak* «taksë për peshim

të drithit; taksë për bagëti të shitur», me o për a për punë disimilitra o nga prirja e gegërishtes për mbyllje të a-së. Jo shumë afër menç është të pranohet një ndikim i fjalës *poshtë*. Khs. dhe Revue de Linguistique VII 1 197, ku flasim për produktivitetin e sufiksit latin *-aticum* në latinitetin ballkanik. Një tjetër trajtë e fjalës është *pash-tréf* te Fjal. i gju. shqipe.

pat. m. «kat i shtëpisë; odë e katit të parë». Pas G. Meyerit (f. 324, te *patë* f.) vjen nga gr. e re **πάτος** «dysHEME», që me zgjerimet e saj ka dhënë në shqipen dhe *patomë*, *patunë* *potillë*, të tria për «shuall i këmbës». Pokështu Weigandi 66, më parë Kamarda I 344. Përkundrazi Candrea-Densusianu 1356 rum. *pat* «shtrat» e shq. *pat* i bien të ardhura nga një lat. **pattus* prej gr. **πάτ** «shteg, hap, dysHEME». Për Pascun (Rum. El. i. d. Balkanspr. 9,71) rum. *pat* vjen prej një lat. **pavatam* «e shtruar», e prej rumanishtes rrjedh gr. e re **πάτος** «fund, thellësi; shuall; shtrat», shq. *pat* e bullg. *pat* «shtrat i drunjte». Puşçariu (Dacoromania IV 1319) e Tagliavini (Studi Rumeni III 89) nisen nga një lat. **patus lectus*, *patum* ose *patuum* «idem est quod patulum id est locus patens et apertus» (Du Cange), pra nga një kuptim «i hapët, i shtrirë», prej lat. *pateor*. Mendim i pranuar — me rezervë — dhe te Meyer-Lübke REW 6302. Sh. dhe Battisti, Avviamento allo studio del latino volgare 66.

Ka një përhapje më të madhe nga sa kujtohet, e mund të quhet fjalë e mbarë shqipes. E ka Buzuku (LVIII, Mbretërit III 17,23) e *bani me stripunë mbë pat pështjerë ndë shtëpi* «et deposuit eum de coenaculo in inferiorem domum»; Bardhi Tabulare *Me patuem me dërrasa*. Mbetet për të parë nëse hyn këtu dhe *pati i gurit* «faqja e lame e gurit, siprina e gurit», si mendon Gazulli. — Kjo fjalë etimologjikut nuk mund të ndahet nga *patós patóz* «katua, quar; qilar; dysHEME» që jep Kristoforidhi (f. 191) për Përmet, Çekrezi përgjithësisht për toskërishten, Leotti, Manni etj., Tase «katua, bimcë, quhër për të grazhduar, për të mbajtur kafshët», nga *patosí* f. «kat» që jep Pedersen 175 për tosk. jugore e nga emri i vendit *Patós*, që në thelb do të thotë «fund, thellësi». Për këto fjalë përhapja gjeografike vetë tregon se rrjedhin prej gr. **πάτος** me kuptimin e **πάτωμα** «kat i shtëpisë; dysHEME, dërrasim». Në greqishten **πάτος** ka dhe domethëniet «fund; truall»; në greq. e Italisë jugore «impalcato, soffitto», Rohlf's EW 1640. Prania e fjalës edhe në Veri, ku ka formuar dhe verbin *patoj*, pas kriterit të Thumbit (IF 26,7) dëshmon që kemi të bëjmë me një huazim mjaft të vjetër, pas gjithë gjasësh prej mesjetës bizantine. Kështu nga fjalët shqipe me burim të dyshimtë, a grek a latin, kjo hyn në ato që vijnë prej greqishtes. Në këto rrethana edhe rum. *pat* «shtrat» si «e shtruar, shtresë» do të jetë po e atij burimi, aq më shumë kur **πάτος** në greq. e re ka dhe kuptimin e shtratit. Andej buron dhe bullg. *pat*, Mladenov 404. Ashtu do të mendohet atëhere dhe për arom. *pat* «lit; chambre, pièce spacieuse où travaillent les femmes et les jennes filles; étage; rangée; talon de botte». Sh. për atë fjalë dhe Papahagi 820.

patështinë f. «bërsi». Spiegimi i kësaj fjale nga serbokr. *voština* «mbeturina dylli», prej sllav. së vj. kishtarë *voskъ* «dyllë», nga ana e G. Meyerit (f. 325), nuk shkon as nga fonetika as nga ana e kuptimit. Me të drejtë dhe Selisçevi s'e shënon ndër huazimet sllave të shqipes. Nuk mund të ndahet fjala nga *patitir* «shkelës i rrushit» prej gr. së re

πατητήρι, nga **πατώ** «shkel», për të cilën sh. G. Meyer 325, Kamarda II 90. Përhapja e fjalëve në tosk. jugore (Manni dëshmon *patështinë* për Përmet, si «bërsi ullinjesh») flet në të mirë të një *huazimi* prej greqishtes. Në formim të fjalës do të ketë ndikuar ndërkaq edhe sllav. *-tina*, sh. *sotinë*.

pedim m. «theka e petkut». Këtë fjalë të geg. veriore G. Meyer 325 e shënon pas Rossit dhe e lë të paspieguar. Sikundër ka treguar Jokli (Rev. Fil. II 255v., 259, IF 49,288) vjen nga rum. *piédin* «fundi i paendur i një pëlthure, thekët», dhe ka kaluar në shqipen nga një dialekt rumun i fqinjësisë, pas gjase nga Rumunët mesjetarë të Drintit. Përpjekja e Bariçit (Arhiv I 152) për ta spieguar këtë fjalë me mjetet e shqipes, nga një bazë **pō-dhwensmos*, e afër me lat. *fimbria* «kind, shundill», nuk qëndron, sh. edhe Jokl IJ X VII 67.

pëjnë f. «thekë e petkut, pedim». Mungon te G. Meyeri, e ka Bashkimi për «fimbria». Candrea-Densusianu 1378 shohin aty refleksin e një lat. **pedinus* «shpatë e vegjve» (që rron ndër të tjera dhe në rum. *pedin* «thekë e pëlthurës»), duke gjetur dhe pëlqimin e Joklit (Rev. Filologica II 255). Si e kemi shtjelluar në Li. Posn. VII 192, fjala nuk është gjë tjetër veçse *pëjna-t*, plurali i *pëni-t*. khs. *me i lanë pëjnat me shkue në mbarim* te Leka IX 38. Khs. dhe Revue de Linguistique VII 1 171. Këtë gjë shohim tani se e ka vënë re edhe Manni f. 358 Mbledhësit e Bashkimit do ta kenë dëgjuar fjalën më fort si pl. *pëjna-t* sesa si sing. *pëjnë-a*. Me gjith'atë ndër rrobaqepësit e Tiranës ndihet dhe singulari *pejna* fem. «peri».

pela-t «dallgët, tallazet». Këtë fjalë të geg. veriore e dëshmon B. Palaj (HD X 84 shën. 27) si *pelat* «tallazet e mëdha», «majet e tallazeve, qi, tănë shkëmë rrxohen nëpër valë» për Brebullë të Berishës: *s'lanë pelat me dalë kush Drinin; s'na lanë pelat me qitë argshin*. Do të jetë një me *pelë-n*. Edhe në të tjera gjuhë dallgët shkumëzuese (të detit a të lumit) quhen metaforikisht prej shtazësh së ndryshme, si kali, dhia etj. Khs. it. *cavallone* «dallgë e detit që ngrihet prej erës», *a cavalloni* «me dallga, me tallaz»: *cavallo* «kalë»; sh. Goidànich Arch. Glot. It. Sez. Goidànich XXI 57, Pisani poaty 53,33v. (r.gj. *moutons* («desh») «dallgë shkumëzuese». Pokështu dhe në shqipen thonë (në Gjirokastër) *vinë dallgët desh-desh*.

pelë f. «femra e kalit», **pelâr** m. «bari kuajsh e pelash». Si e vu-ri re sëpari Xylander 279 (e pas tij Stieri Nr. 33a me Kamardën I 172), e afër me gr. **πῶλος** «mëz, zog shtaze; djalë i ri, vajzë e re». Aty hyjnë ndër të tjera edhe got. *fula* (gjerm. e sotme *Füllen Fohlen*) «mëz» e me rezervë dhe lat. *pullus* «zog shtaze, zog pule» etj. Khs. sidomos G. Meyer f. 326 e AS III 88, Boisacq 830, Walde-Pokorny II 76, Tagliavini 218, Walde-Hofmann II 386, Pokorny I 843, Hofmann GEW 292, Baric Hýmje 22.76. Si bazë e fjalës shqipe do të mendohet (me Joklin, Kretschmer-Festschrift 1926 f. 38) një **pōl-n-ā*. Më një tjetër vend (LKU 263) ky dijetar pranon mendimin e Fickut (II⁴ 240) që *pelë* afrohet me irl. *lair* gjind. *larach* «pelë», kjo prej një baze **plārek-s*.

Fjalë e mbare gjuhës, pranë *mëz*, *kalë* e dialektos mëshâl. Përdoret figurativisht në veçori në rritur, ashtu që shihet si «kalë» në greqishten e vjetër. Del që te Buzuku (LXXV 10,34): *e tue vum atë përmbi një pelë; te ti, e shpë mbë një ostarë*.

BIBLIOTEKA SHKENCËRE
UNIVERSITETI SHTETËRORE
JE INV. 8504

LIBRARI
HISTORIKO-GJUHËSHE
1989

imponens illum in iumentum suum, duxit in stabulum». Bardhi Equa, cavalla *Pela*. Në Veri *pelë* pas Nopcsës 136 shënon dhe dyrekun e tortkut të ullinje; khs. për një përdorim të tillë arom. *calar* «kalorës; trari i kulmit, kulmar», frgj. *chevalet* «sqele» etj., Meyer Lübke REW 1440. Prej *pelë*-s duket të ketë dalë *pel'atores* f. «drenushë e vogël, cervetta» *pel'atorët* «drerët» te G. Dara prej Palac Adrianit në Siqeli (f. 226, 124), me një zgjerim me *-atuar -atuer* fem. *-atore* si të tjerat emra shtazësh, *ethatuer* «dem, ter, mëzat» *mëzatore* «lopë që ka pjellë e të cilës ja kanë hequr vëçin». Te N. Brankati nga Piana (shek. i XVIII) në një këngë fetare *Xa që zuri kjo l'angore Një të bukur pil'atore*, të cilën Kamarda (II 183,200) e merr për «vjedhull» dhe e nxjerr kështu, pa të drejtë, prej lat. *piliare* «marr» *piliator* «plaçkitës».

pellg m. «gropë e madhe me ujë, gomën; vend i thellë në ujë (në det, në lumë etj.)»; në *pellg të dimnit* «në mes të dimrit» (kuptimet «trevë, krahinë» etj. kanë dalë prej shkollës); *pellgaçe* f. «llogaçe, pellg me ujë»; *pellgore* f. «vend i madh e i thellë e plot me ujë»; *pellgovinë* f. «ligatinë» (me sllav. *-ovina*). Ndërsa Kamarda (I 40,66) e afronte me gr. *πέλαγος* «deti i hapët», G. Meyeri (f. 326, më parë Alb. Studien I 24) mendon — me rezervë — për një afrim me lit. *pélke* «lëgatë, moçal me thëngjill turbë», gr. *παλλός πηλός* te Heziku, lat. *palūs* «ujë amull, ligatë, kënetë». Kundër një spjegimi të Bariçit (Arhiv za arb. starinu I 151v.) nga një bazë **po-leugā*, duke e lidhur fjalën kështu me *lëgatë* lit. *liūgas* «pellg, lëgatë», sh. Jokl IJ X VII 67, Rev. filologica II 216v Barazimin e G. Meyerit e pranon Walde-Hofmann II 243, ndërsa Walde-Pokorny II 66 përsjat dhe mundësinë e burimit të fjalës shqipe nga gr. *πέλαγος*. Te barazimi i vjetër *πέλαγος* : *pellg*, po me një formë të zgjeruar, kthehet Loewenthal, Wörter und Sachen X 176. Duke u nisur nga një më e moçme **pellëg* **pelag*, Jokli (Reallex. d. Vorgeschichte I 87) fjalën e shqipes e lidh me emrin e popullit ilir *Πελαγόνες*. Sh. edhe Krahe Die Spr. d. Illyrier I. 111, A. Mayer II 89,90.

Si e kemi shtjelluar dhe në Bul. për Shk. Shoq. 1 (1956) 130 shën. 7, baza *pellëg* supozuar prej Joklit ka ekzistuar: Buzuku (XL, Korintasit II 11,25) *një natë e një ditë jam klenë mbë pellëgut të detit me votë n fond* «nocte et die in profundo maris fui», Budi (SC 199) *rrëzonetë e bie ndë pellëgutë zi e të pafund të zja(r)mit amëshuom*. Nga pozita intervokaliqe e *l*-së spjegohet tani dhe karakteri velar i saj: *pellg* jo *pelg* *pelk*, si mendonte gabimisht Pedersen (KZ 33,548), pas Dozonit. Kjo gjë përjashtonte çdo krahasim me lit. *pelke*. — Duke mbetur i drejtë afrimi me emrin ilir *Πελαγόνες*, nuk mund të hidhet poshtë një lidhje e *pëllëg*-ut me gr. *πέλαγος*, të cilën pas Kamardës e pat përsjatur dhe G. Meyeri. Me gjithë se lloji i afërisë të së dy fjalëve nuk është sqaruar (sh. tani dhe Bul. i Univ. Shtet. të Tiranës, Seria Shk. Shoq. 4, 1962, 131,146), me qenë se *πέλαγος* gjen spjegim brenda greqishtes, kemi të bëjmë më fort me një huazim të shqipes nga greq. e vjetër sesa me një fjalë të afërisë indoeuropiane; khs. tani dhe Marlekaj, Quaderni V 51. Kuptimet që ka *pellgu* te autorët e vjetër të Veriut e afrojnë atë edhe më fort me fjalën greke. Për të tjera huazime të shqipes prej greq. së vjetër në fushën e detarisë e të lundrimit sh. dhe *kum*. II., *liqën*. — Me fjalën e shqipes Rosetti (Istoria limbii romine II⁴ 109) afron rum. *bîlc* «flaque, mare, bourbier». Mbase nga shqipja, e pikërisht nga faza e vjetër *pellëg*, mund të rrjedhë serbokr. *pelega* «një vend në det, nja

300-400 pash larg nga bregu», të cilën G. Meyeri anon ta nxjerrë nga gr. Πέλαγος.

pendull f. «pendë». Këtë fjalë të Rossit (shkruar *pendull pennull*) G. Meyeri 326 e vendon te *pendë*, pra e merr si një zgjerim të kësaj me -ull. Candrea — Densusianu 199 e afrojnë me rum. *panura* «cohë, shajak». duke i çuar të dy fjalët te një lat. *pinnula*. Jokli (LKU 302 shën. 1) nga lat. *pinnula* **pennla* spiegon *penlë* f. «pupël» që jep Kujunxhiçi 46.

Janë të gjitha zgjerime të brendshme të *pendë*-s: *pendull* është *pand-ull*, *penlë* është = *pendël* «pupël», zgjerim i *pendë*-s me -l(ë) deminutive, si *pupël*, *zogël*, *grizhël*.

perëndi f., m. Fjalë me burim të diskutuar, latin a autokton. Duke u nisur nga *perëndi* «Imperator» e Bardhit, Boppi (f. 515 shën. 1,520 shën. 1) te kjo e te *perëndi* «Zot, hyjni» sheh një fjalë me kuptim të hershëm «zot, sundues», dhe kështu e spiegon këtë nga një shformim i temës participiale latine *imperant*. Poashtu dhe G. Meyeri (f. 328) te *perëndi* gjen refleksin e lat. *imperantem*, zgjeruar me atë sufiks -i që formon abstrakta femërore e që del dhe te *njeri* etj. Ashtu edhe Ribezzo Riv. d'Albania II IV 345. Një fjalë vendi përkundrazi sheh aty Pedersen BB XX 229 vv. Si vë re dhe kuptimin «qiell» (pas Dozonit f. 66 në Hidra të Greqisë, te Mitko 57 *thekëri gjer më çati, gruri gjer mbë perëndi*, e ka dhe Dine 658), ky dijetar te *perëndi* gjen një kompozit *perëndi*. Aty pjesa e parë sipas tij i përgjigjet emrit të hyjnisë së lashtë *Perunъ* të Sllavëve paganë, lit. *perkunas* «bubullimë, zoti i bubullimës», e pjesa e dytë -di fjalës *ditë*; tek emri sllav ai sheh një huazim prej ilirishtes. Këtë barazim e zgjeron Leowenthali (Arkiv f. nord. fil. Neue Folge 29,99vv.), duke përfshirë në të dhe ind. e vj. *Parjanya-* «zoti i shiut e i stuhisë», gr. *περαυνός* «rrufe» etj. Pranuar dhe te Brugmanni (Grundriss I 514), te Brückneri (KZ 50, 161vv.) e te Lambertzi (f. 149, Alb. Märchen 48v.). Ky dijetar i fundit shton nga fusha e shqipes dhe e *premtë* bashkë me emrat vetiake *Prend Prende Prendush*, duke shikuar te *perëndi* një zot iliro-trak të stuhisë e të qiellit. Khs. edhe Oştir Arhiv za arb. starinu I 96, 109, Treimer poaty I 32v., KZ. 65, 88, Jokl Archiv. Romanicum XXIV 34, Vasmer REW II 346, Fraenkel 575. Bariçi (I 124) e Pisani (Arch. Glot. It. 24, Sez. Goidanich, 1931, 65 vv.) te pjesa -di e *perëndi*-së gjejnë refleksin e indoeur. *Dieus* (lat. *Iovis*, gr.

Ζεύς etj.), ashtu si dikur dhe Kamarda (I 341). Kundra Pedersenit sillet G. Meyeri vetë (Alb. Studien IV 55), duke iu mbajtur etimologjisë latine. Në truallin indoeuropian qëndron Weidemann BB XXVIII 12 me Bartholomaenë (IF 19, Beiheft 190v.), po duke përsjatur një afëri me av. *parōndi* «gjeniu i mbushullimit e i burisë». Kundra Pedersenit edhe Walde-Hofmann II 413. Khs. dhe Walde-Pokorny II 42 e për Derzavinin Jokl IJ XII VII 84. Bariçi më vonë (Arhiv za arb. starinu I 152 shën. 1) e zbërthen fjalën në *pe-rëndi*, duke afruar -rëndi me *vrendë* «një vesë shi».

Fjalë e mbarë gjuhës. Në Myzeqe ka një fshat me emrin *Perondi*. Në Bosnje një emër familjeje *Perëndija* (Skok, Rad 222 f. 132). Për hetimin e etimologjisë ka rëndësi historia e kuptimit të fjalës. Në shqipen e vjetër të literaturës së Veriut e të kolonive të Greqisë e t'Italisë emri i hyjnisë është *Zotynë*, *Ynëzot*, me lakimet që paraqet në ratat e ndryshme. Buzuku s'e ka fare fjalën *perëndi*. Budi (RR 354, DC 36, SC 38) ka *Ke dëshëronjënë engjij e shintënë të lëvduom T atinë Pe-*

rëndi me sÿ me e shukuom, e (te Ati ynë) artë perëndia jote «veniat regnum tuum»... *Krishtnë, qi tashti perëndon mbë qiellt për «zotëron, sundon»*; Bardhi Caesar *Perëndi*, Imperator *Perëndi turcice Sultan*, Imperatrix *Perëndesha*; Bogdani (I 7,4; 36,16; 137,1; II 7,9) *Perëndia i Turqisë «l'imperatore di Turchia»*, G. Cezarë *Perëndin e Romësë «G. Cesare Imperator Romano»*, katër *Perëndija «quattro Monarchie»*, *perëndeshë «imperatrice»*. Nga këto dëshmi del e qartë se — si e pa edhe Boppi me G. Meyerin — kuptimi i fjalës ka qenë në të parë profan, dhe përdorimi fetar i hyjnisë është i pastajmë e ka dalë prej atij; kështu ka ngjarë dhe me fjalën *zot* e me shumicën e emrave të hyjnisë më të lartë në gjuhët më të ndryshme. Kuptimi i kryehershëm ka qenë ai i një abstrakti më -i «të qenët zot; zotëri, zotërim, sundim», prandaj edhe gjinia femërore e emrit. Nga ky kuptim, i cili pasqyrohet ndër të tjera dhe te *perëndon* (sh. këtë fjalë), u zhvillua me kohë një nomen agentis «zotëronjës, zot», e prej këndej më në fund «Zot, Deus». Krah për krah me këtë zhvillim semantik nga përdorimi profan në fetarin e nga një nomen actionis në një nomen agentis do të ketë shkuar dhe kalimi krahinor i emrit në gjininë mashkullore (o i *madhi Perëndi*), kalim që lidhet me një personifikim, me përfytyrimin e hyjnisë si një qenie mashkull, ashtu si te *Zot*. Nga këto tri shkallë kuptimore (abstrakt; konkret; hyjnzim) ajo e para ruhet te *perëndia jote «regnum tuum»* e Budit, së cilës prej Buzukut (XIXa, XXVb) i përgjigjet *Artë regjënja jote*; te *perëndia jote* kemi pas gjase një formulë të moçme të gjuhës kishtarë, meqë gjindet krejt ashtu dhe te Matranga 28. E dyta shkallë, ajo e përdorimit konkret të sunduesit («Caesar, imperator»), bën ballë sëpari te autorët më të vonë Bardhi e Bogdani. Faza e tretë, e sotmja, «Zot», nuk çfaqet në literaturën e vjetër, e pas gjithë gjendjes është më e re. Edhe më e vonë është *perëndeshë* — emër mocioni nga *perëndi* marrë si mashkullore — me kuptimin «hyjneshë»; përdorimi popullor e ka për «imperatrix» (Bardhi), në arbërishten e Siqelisë «regina» (Kamarda I 166, 341); neologjizëm është dhe i *perëndishëm «hyjnor»*. Duke shikuar çështjen e etimologjisë së fjalës nëpërmjet të historisë së saj, shihet se burimi i saj nga lat. *imperantem*, zgjeruar përbrenda shqipes me -i, është më bindës se çdo tjetër afrim. Edhe Hahni (I 268), me gjithë se është i pari që krahason fjalën me sllav. *Perunъ*, dyshon në një afrim me këtë, duke arsyetuar me të drejtë se analiza e saj çon në *perënd-i* e jo *perënd-i*. Kështu *perëndi* është një nga ato fjalët e shqipes, për të cilat duhet kthyer prapë te etimologjia latine; sh. tani dhe Revue de Linguistique VII 1 196. Rrethana që lat. *imperator* ka hyrë një herë në shqipen (si *mbret*), nuk i prish gjë këtij spjegimi; të tilla dubleta latine nuk mungojnë, khs. *dreq: drangua*. Sa për rënien e para-fjalës *im-* te *imperantem: perëndi*, le të vihet re se dhe në rumanishten *imperator* përveç *impărat* ka dhënë dhe *părat* (Puscariu EW 785); khs. dhe Jordan, Limba rom. contemporina 314. Nga fusha e shqipes hyn këtu dhe *impedicare: pengoj* (G. Meyer, Alb. Studien IV 55). Më anë tjetër një *perënd-i* e periodës indoeuropiane në shqipen pritej më fort të kishte dhënë **perēni*, me asimilimin e rregullt *nd: n*, sh. Bul. për Shk. Shoq. 4 (1953) 35. Pëkundrazi *nd-ja* e *perëndi-së* shpie te *nt*, që edhe kjo na çon te lat. *imperantem*.

perëndón (dielli). I përgjigjet gr. së re *ó ἥλιος βασιλεύει «dielli perëndon»*, në thelb «dielli mbretëron». Është një çështje fort e diskutuar se në cilën nga dy gjuhët ballkanike e ka burimin kjo shpreh-

hje; një vatër e tretë është rumanishtja, ku për «dielli perëndon» thuhet *soarele asfînteşte* «dielli shenjtëron». Pas Joklit (Mitt. d. Rum. Inst. Wien I 298 vv., LKU 13) *perëndon* ka dalë nga **për-anë-ton* «priret nga një anë», formë paralele me *pranoj* = *përanoj*, dhe si u vu në lidhje, në ndjenjën gjuhësore, me *perëndi*, pas këtij ndikimi u përkthye në greq. e re, duke dhënë atje *ὁ ἥλιος βασιλεύει*. Edhe më parë Pedersen (BB XX 229) kish menduar se më fort gr. *ὁ ἥλιος βασιλεύει* ish formuar pas gjedhes së shprehjes shqipe sesa kjo pas asaj të greqishtes. I mendimit të përkundërt është Hesselingu (Neophilologus 5,165 vv.), duke vënë në dukje ndër të tjera se fraza e greqishtes dokumentohet që me vitin 1365; po sh. ndërkaq kundërvrejtjet e Joklit (IJ IX VII 33), ku tregohet se Epiri, Akarnania e Etolia shumë kohë para asaj date kanë pasur një popullësi shqiptare. Për mendimin e Joklit e të Pedersenit shprehet dhe Høegu Les Saracatsans I 46 shën. 1. Nga teza e burimit grek anojnë ndër të tjerë Bogrea (Omagiui lui I. Bianu 51' vv.), Spitzeri (Revue Intern. d. Et. Balk. II 224v.) e Kriaras (*Ἀθηνᾶ* 47,79 vv.; Revue Intern. d. Et. Balk. III 462 vv.), po sh. edhe Jokl IJ XIII VII 105, XXII VII 209, XXIII VII 204. Kretschmeri (Glotta IX 221v., X 38vv.) mбет ndërzysh, Sandfeldi (f. 68v., me literaturë) e quan çështjen të pazgjidhur. Khs. edhe P. Papahagi Jahresber. d. Rum. Inst. Leipzig XIV 139 Nr. 191, Dölger Byz. Zeitschrift 37,517, Tagliavini Miscellanea Jespersen 413vv., Rohlf's EW 315 e LG 80 sëfundi Andriotis 33.

Fjalë e mbarë gjuhës, po që te autorët e vjetër të Veriut (Buzuku, Budi) paraqitet e zëvendësuar me *rri*, *ndejt* *dielli*. Buzuku nuk ka as *perëndi* as *perëndon*; te Budi gjinden të dyja, po *perëndi* për «regnum, mbretëri, zotërim», e *perëndon* për «zotëron, sundon»... *Krishtnë, qi tashti perëndon mbë qiell; e t i thoetë gojë plot, e sikur me një të madhe puçtet perënduoshim*... (SC 38, RR 275). Midis shq. *perëndon*, gr. së re *βασιλεύει* e rum. *asfînteşte* ka një paralelizëm kuptimesh pothuajse të plotë. Kështu shprehjes shqiptare *sytë më perëndojnë* i përgjigjet gr. e re (prej Epirit) *τά μάτια μέ βασιλεύουν*. rum, *și din cînd in cînd ii asfînteau ochii*, sh. edhe Hanh I 98, *Ἰστορ. Αέξ. τῆς νέας ἑλλη-νικῆς* III 474, Dict. li. rom. contemporane I 128. Edhe përdorimi transitiv i shqipes *perëndoj sytë* «i prier nga njëra anë», në shqipen e Greqisë (Reinholdi) «jap shpirt, mbyll sytë» (sh. edhe Pedersen loc. cit.), del në greq. të re: *βασίλειψαν τά μάτια του ἔχασαν τήν ζωηρότητα των ἔνεκα νόσου ἢ ὑπνηλίας* te vendi i cituar, khs. edhe Dimitrakos II 1360. Kuptimi metaforik «zhdukem» (*njera çë perëndoj* «finché spariva» te Dara 34) del edhe ky në greq. të re, nëpër dialektet *βασιλεύομαι γίνομαι ἄφαντος, ἔξαφανίζομαι: βασιλεύει τό νερό. διεισδύει εἰς τό ἔδαφος, τό καταπίνει ἡ γῆ*. — Jokli ka të drejtë kur si kuptim të parë të fjalës merr «prirem, anoj». Kjo shihet jo vetëm në fraza si *perëndon pas asaj* «e admiron, vdes për të» (khs. *viret mbas asaj*), po edhe prej shprehjesh si *më prenonte kryet* (mbi kalë) «po më zinte gjumi, kotesha, falesha» (Poroçan, Verçë). Në Dibër, është i zakonshëm transitivi *perëndoj* «pështet, vendoj» (një send në një vend), me refleksivin *perëndohem* «përshtetem», *perëndou* «pështetu (te muri, më një shkop etj.)», te Bageri 18 (si vuri re edhe Jokli)... *plaku... pa mos a perëndue më shkopt*. Me *perëndoj perëndohem* lidhet me anë të këtyre kuptimeve edhe *m'u prenditën syt* «m'u mbyllën sytë nga lodhja» në Seman të Fierit (J. Thomaj. Bul. i Univ. Shtet. të Tiranës. Ser.

Shk. Shoq. 4, 1961, 150), khs. më sipër *më prenonte* kryet. Këto të dhëna tregojnë se *perëndon dielli* në shqipen spjegohet me mjetet e brendshme të gjuhës, si një kalim nga «prirem, anoj» në të perënduarit e diellit. Një zhvillim paralel e shohim te *falem*, më një anë «nderot hyjninë, lutem», «e kotem, ul kryet kur më zë gjumi», më anë tjetër *u fal dielli* «perëndoi dielli», *u fal drita* «u shua drita», të gjitha nga kuptimi konkret «prunjem». Në të tilla rrethana nuk mbetet vend të mendohet që shprehja t'i ketë ardhur shqipes prej greqishtes. Anasjelltas dëshmimi i vonë i saj në greqishten (shek. i XIV) flet më fort për një ndikim nga ana e shqipes, sepse kronologjikisht pajton me përpjekjet historike të së dy popujve e me dyndjen e elementit shqiptar në Greqi. Sido që të jetë, çdo përpjekje për të spjeguar shprehjen greke nga greq. e vjetër, si pa bazë që është, është e caktuar të dështojë. Edhe rum. *soarele asfintește* mund ta ketë burimin te shqipja, po të kemi parasysh që nga tri gjuhët ballkanike vetëm te kjo e fundit kuptimi konkret i animit e kuptimi abstrakt i zotërimit ruhen gjer më sot krah për krah njëri-tjetrit. Kalimi i mëtejme për perëndimin e diellit vihet re dhe te *zotëroj*, që në Qeparo të Himarës e në Bëncë të Tepelenës përdoret dhe për perëndim të diellit: *dielli zotëron, zotëroi dielli*.

perikót f. «tullë, qerpiç i pjekur». Fjalë e Semanit të Fierit, sh. J. Thomaj, Bul. i Univ. Shtet. të Tiranës, Ser. Shk. Shoq. 4, 1961, f. 150. Te Manni *perikot* m. «brick, tile», për toskërishten. Nga ven. *pieracota* «tullë», që përdoret dhe në Borgo Erizzo si *pjer e kota*, sh. për këtë Tagliavini 221.

perime fpl. «barishte, zarzavate». Mungon te G. Meyeri. E jep sëpari Bashkimi për «erbaggi», poashtu edhe Busetti. E vë në dyshim Xhuvani (Kritikë për fjalorë të shqipes 13, Minerva II Nr. 27 f. 22), po e dëshmon Logoreci (HD X 594) për geg. veriore. Jokli (IJ XXIV VII 141) vren se pa të drejtë Cordignano² (te *puré*) e bie si fjalë turke.

Me këtë mbase do bashkuar dhe *perihime* «desert, paslugë» që përdoret në Labëri; atëhere *-h-*ja do të ishte një tingull kundra hiatit. Sidoqoftë, *perime* është një shformim i *prime* «mjekime të mjekësisë popullore me yshtje e të tjera punë kësodore», sh. *prime*. Nga «mjekime» u zhvillua «bare», që përmbledh dy kuptimet; «mjete mjekimi» e «bimë e blertë, herba», e së këtëjmi mënefund «barishte». Si fjalë e gjuhës së përgjithshme *perime* është e re, duke u ndarë nga *prime* në trajtë e në kuptim. Mundet që *perime* me *-e-*në e saj të jetë një sajim i letrarëve të Veriut.

perishtúp, prishtúp «visek»: *vjetë perishtupe*. Fjalë e geg. veriore, që s'e ka G. Meyeri. Me të drejtë Kristoforidhi 497 e bie si fjalë me burim sllav, po spjegimi i tij nga një *peristup* nuk është drejtë. Si fjalë e Veriut është një huazim krahinor nga serbokr. *prestupna* (godina) «vit visek», p.sh. te Ristić-Kangrga 744,1242, Vuka 608 *prijéstup*; sh. Bul. për Shk. Shoq. 3 (1954) 74.

perupí f.: sh. *porropí*.

peshë f. II. «gur që hedhim, sidomos për të gjuar një shenjë». Këtë fjalë Miklosichi më parë (AF II 618) e G. Meyeri 336 e vënë bars me *peshë* I. nga lat. *pe(n)sum*; poashtu Tagliavini 219, i cili për Arbë-

nesh të Dalmacisë e jep fjalën si mashk. *pes*-i e me kuptimin «gur (i vogël); gur (sidomos petashuq)». Edhe Weigandi 67, Lambertzi 152 e FGS e marrin si një fjalë me *pes*hë I. Pederseni përkundrazi (f. 6, IF 5,47) sheh aty një fjalë vendi të shqipes, duke e afruar me ind. e vj. *pansūs* av. *pasnu-* «pluhur, kum» e me sllav. e vj. *kishtarē* *пѣсѣкъ* rus. *pesók* «rërë, kum». Ky krahasim nuk përmendet nëpër fjalorët etimologjikë.

Fjalë e geg. veriore. Përveç se te Jarniku, prej të cilit e mori G. Meyer, del dhe te Kujunxhiçi 60, e tani dhe te Jeta e Re (maj-gershor 1955, f. 197) *T'kite ata pes*hë me *qitë*, nga Koqa-Gorvoka. — Afrimi që bën Pederseni nuk është fort afër menç, kryesisht për arsye të kuptimit: *pes*hë nuk është një gur aq i vogël; Kristofiridhi e ka për: *πέτρα βαρεία μεγάλη*. Po edhe nga ana fonetike do shënuar se baza **pens-* që vendoset në atë mes do të kish dhënë në geg. veriore një refleks me vokal nazal, **pëshë*, i cili nuk duket gjëkund. Për këto arsye *pes*hë II, pas gjithë gjasësh është një me *pes*hë I. Nuk do heshtur ndërkaq se fjala latine nuk ka dhënë në gjuhët romane askund kuptimin e gurit që hedhim. — Një kompozit *gurapësh* (me hyrje të një -a-je në mes, si te *Gurakuqi*, *Guralumi*) «lojë me se sprovohet kush e hjedh *pes*hën mâ larg» (me luejtë *gurapësh*), jep Gazulli prej Kryeziut të Mirditës. Ky kompozit me dy sinonime (tipi *dobromirë*) gjan të ketë dalë prej një lidhjeje *gur pes*hë, me *pes*hë si atributiv, «gur që është *pes*hë, gur i rëndë». Prej *gur pes*hë ose prej *gurapësh*, me anë të një elipse, duke mbetur jashtë *gur*, u arrit në *pes*hë. Në formim të kësaj kanë ndihmuar ndërkaq edhe shprehje si *ngre pes*hë atë dash, e çoj *pes*hë, u çue *pes*hë, ma çoi zemrën *pes*hë, ku *pes*hë mori rrugën e një adverbi lokal me kuptimin «përpjetë». Pas këtyre do të jetë formuar *hudh pes*hë «hedh gurë», ku u abstrahua *pes*hë «gur që hedhim». Në çdo rasë *pes*hë ka dalë në ngërthim të fjalisë nga një elipsë, nga *gur pes*hë a nga *hudh (gurin) pes*hë.

*pes*hk m. Nga lat. *piscis*, sh. Miklosich, G. Meyer 329, Alb. Studien IV 125, Tagliavini 219, Walde-Hofmann II 310.

Fjalë e gjuhës mbarë. Buzuku (LXXIV = LXXXIV, Luka 5,6 2) *E si rjetë patnë shtim, zunë të madh pes*hk «Et cum hoc fecissent, concluderunt piscium multitudinem copiosam»; e *si sosh ishnë dalë pes*hkëtarë e por lanjinë rjetë «piscatores autem descenderant, et lavabant retia»; Bardhi *Piscis Pes*hk, *Piscari Me pes*hkuem, *Piscaria Pes*hkaria, *Piscator Pes*hkëtâr, *Pisciña Vendi ku zihetë pes*hku, *Piscosus Plot me pes*hk. Nga këto të dhëna shihet se *pes*hk përdoret shpesh si kolektiv; ashtu dhe te Bogdani (I 112,5): e *pā pes*hkuq *qi bijnë prej Dëti* «e senza i pesci, che li portavano dal Mare». Forma *pes*hkëtâr e këtyre dy autorëve tregon se *pes*hkatâr me -a-në e saj është më e vonë. Neologjizma janë *pes*hkatâr i f. e *pes*hkim m., popullore është *pes*hkatore f. «një lloj ëmbëlsirë»; gjithashtu popullore janë *pes*hkaqën *pes*hkaqën m. «Squalus», përkthim i it. *pescecane*; *pes*hksqyt m., pas it. *pesce scudo*, *pes*hk-sharrë «Pristis pectinatus» pas et. *pesce sega*, *pes*hk-shpatë «Xiphias gladius» pas it. *pesce spada* etj. Me *pes*hk duket të lidhet me *pes*hkh m. «një lloj mole» te Fjal. i gju. shqipe. — Një sqarim kërkon forma e fjalës. Te *pishk* e tosk. jugore dhe e kolonive të Greqisë e t'Italisë (del që te A. von Harifi: *pyske* «vyssche», M. Roques, Le dict. alb. 49) duhet parë me G. Meyerin një trajtë që i-në e mori nga pl. *pishqit*, pra një plural i singularizuar; në tosk. jugore u ka formuar kështu një skemë e re *pishk*:

pl. *peshq*, si te *rrëshék* që ka arritur në Veri të *rrëshiq*: pl. *rrëshekë*, sh. vrejttjet tona në Li. Posn. VIII 106. Ndërkaq mendimi që *peshqe* të ketë dalë nga një lat. *pescem* e *peshk* nga një **pescum* e rindërtuar (G. Meyer, Pušcariu EW 1300), nuk është' i drejtë. Lat. *pisce(m)* dha në shqipen rregullisht *peshk*, me hapjen e zakonshme të *i-së* së shkurtër (e të hapët) para dy konsonanteve në *e* (sh. për këtë Meyer-Lübke Gröbers Grundriss I² 1045, Jokl LKU 21 v.) e me apokopë normale të *-e-së* te *pisce(m)* në shqipen, sh. vrejttjet tona Li. Posn. VIII 113v.; *peshqe*, në qoftë se ekziston vërtet, është plurali me *-e* i singularizuar, poashtu siç është edhe *pishk*. Për karakteristikën e huazimeve latine të shqipës është për të vënë re ndërkaq *peshku i kurrizit* «boshti, shara e kurrizit»; te Bashkimi *peshku i shpinës* «rene, reni», *peshk thiut, kaut* etj. «filetto di porco. bue ecc.», te Weigandi 67 «Lende, Filet, te Palaj (HD XIX 184) *E i a lmojn ato peshqit e shpinës*, në Pukë *peshqit e shpinës* «dy anët e kurrizit», *peshku i thiut*. Del që te Buzuku (LVII/2, Mbretërit IV 4, 29; LXXXVII/2 = LXXXXVII/2, Libri i Proverbevet 31,17): *Shtrëngo pishqitë e tū* «Accinge lumbos tuos», *Shtrëngo i fuqie pishqitë e saj* «Accinxit fortitudine lumbos suos»; Budi (RR 92,98) *duhetë me e vojuom ende mbë kambët e mbë pishqit*, edhe ky për «lumbi»; Bogdani (I 64, 7 e 8; 65,13) *Peshqitë shpinësë saj kini me ngjeshunë* «Renes vestros accingetis»; *Shqyrëtou zemërat', e pishqitë nierit Zotynë* «scrutans corda, et renes Deus»; *Pishqitë taj ngjishëni* «Renes vestros accingetis». *peshku i kurrizit* edhe në Borsh të Bregut të Detit (M. Totoni). Me këtë shqipja piqet me gjuhët romane të Perëndimit: it. *pesce* «muskël i krahut» logudor. (sardisht) *piske de sa gamba*, abruc. *pese* «pulpë» etj., te Meyer-Lübke REW 6532; khs. dhe serbokr. *ribić* «peshk i vogël» e «muskël» (Ristić-Kangrga 893).

pezëm m. «malcim, acarim»: *varra më ka marrë pezëm*; zemërim, grindje»: *u ka hÿ pezmi*; *pezmató* «malcoj, acaroj (plagën); zemëroj, inatos»; *pezmatohem*: *u pezmatue varra*; «zemërohem, inatosem»; *pezmatím* m. «malcim, inflamacion; zemërim». G. Meyeri 336 e jep si *pëzmetoj pëzmetoj* *pëzmetim*, dhe duke u nisur nga *për-zmetonj*, e spiegon nga sllav. e vj. *smeta* «turbo», serbokr. sloven. *smetati* «me trazue, me turbullue, me pengue», prej nga rrjedh dhe rum. *smintesc* «trazoj, shqetësoj». Selisçevi s'e rendit ndër huazimet sllave të shqipës. Me më të drejtë Kristoforidhi f. 305 bën një afrim me gr. *πεισμα* «kokëfortësi, inat», po pa u shprehur më saktë për karakterin e kësaj lidhje. Kemi të bëjmë me një huazim të shqipës nga greqishtja, i cili, si fjalë e gegërishtes, i përket një kohe mjaft të vjetër, periodës bizantine, sh. Bul. për Shk. Shoq. 2 (1954) 47v. Del që te Budi (SC 205, 312): *Ke vjën sikur idhunë e pezmatuoshim me gjukuom të gjallëtë e të vdekunitë; mb atë ças djajtë e lëshuonë e u larguonë nci gjith idhunë e pezmatuom*. Një tjetër indic vjetërsie është reflektimi i *i-së* greke (*ει* = *i*) me e përpara dy konsonanteve, ashtu si te huazimet latine të tipit *missa*: *meshë* (sh. për këto Meyer-Lübke, Gröbers Grundriss I² 1045). Përkundrazi është irrelevante për kronologjinë e huazimit *-z-ja* nga *σ-a* greke, se dhe në greqishten vetë kjo germë fonetikisht po *z* është. Për punë, të *-i-së* së ruajtur më e re është tosk. *pizmë* f. «zemërim i fshehtë», *pizmós* «zemëroj, inatos». Me këtë trajtë ka hyrë fjala greke dhe në rumanishten: *pizma*.

pëdhitë f.: sh. *podhé*.

pëllás m. «pallat». G. Meyeri 319, ndërsa *pallat* e spiegon prej gr. së re *παλάτι*, *pëllas* bashkë me *ρυγás* të shqipes së Kalabrisë e nxjerr nga it. *palazzo*. Mendimin e tij e ndjek dhe Helbigu 91. Përkundrazi më parë (Gröbers Grundriss I § 35) Meyeri *pëllas* e spiegon nga lat. *palatium*. Këtij mendimi i mbahet Meyer-Lübke, Gröbers Grundriss I² 1051, dhe ashtu mendojnë dhe Candrea — Densusianu 1330. Edhe Jokli (LKU 92 vv.) sheh këtu një fjalë që është më e vjetër se huazimet italiane të shqipes, veçse e lë të hapët çështjen a kemi të bëjmë me një huazim nga latinishtja ballkanike, apo nga dalmatishtja drejtpërdrejt, apo nga dalmatishtja nëpërmes të serbokroatishtes (serbokr. *palaca* nga dalmatishtja, kjo prej lat. *palatium*.) Më vonë (Balkangerm. u. German. im Alb. 133) ai është drejt për një huazim prej latinishtes. Sh. edhe Skok, Zbornik Radova Filoz. Fak. Sveučil. u Zagrebu I (1951) 445vv.

Budi (DC 182b, CS 137) ka *Ndë pëllas të prānuom*, shumësi *E ato pëllise e bashtinë, e begatī*; Bardhi *Palatium Pëllas*. Siç shënon edhe Jokli, fjalën e ka dhe S. Frashëri. Gjindet dhe te de Rada (Skanderbeku i pafaan V, libri IV, historia IV f. 17): *Te pëlesset*, sh. Li. Posn. VIII 123, në Pallagorio (po në Kalabri), si u tha, *ρυγás* në Molize (Lambertz KZ 53, 296) *puás* shm. *puase*, nga *ρυγás pëllás*, te Cirese 46 *ρυγας*. Pra kemi të bëjmë me një fjalë të mbarë gjuhës. Duke u përjashtuar burimi italian për këtë arsye si dhe për trajtën fonetike, është m'anë tjetër larg mendsh që një fjalë e gjithë shqipes si kjo të ketë dalë prej dalmatishtes. Forma dhe shtrirja e saj flasin për një burim të drejtpërdrejtë prej lat. *palatium*. Më pak të gjarë ka një ndërmjetësi e greqishtes (gr. e mesme *παλάτιον*), e cila ndërkaq më vonë ka dhënë tosk. *pallát!* — Sh. dhe *pulláz*.

pëllëmbë pëllëmbë f. «shuplakë e dorës; shpullë, flakaresh, shuplakë; masë gjatësie me dorë të hapur, nga gishti i vogël gjer tek i madhi», sh. për këtë sidomos Nopcsën f. 5. G. Meyeri 331 e AS IV 93 e spiegon nga gr. e re *παλάμη* «pëllëmbë «e dorës» (*παλαμιά* «shpullë»), poashtu dhe Weigandi 67. Puçcariu EW 1249 lëkundet midis këtij burimi dhe një lat. të rindërtuar **plama* në vend të *palma*.

Fjalë e mbarë gjuhës. Bardhi *Palma Pëllamba*, Palmarius *Njaj pëllambe*. Trajta *pëllangë* e Budit (DC 20 *ndë pëllangë të dorësë*) spiegonet fonetikisht nga *pëllambë*, me anën e asimilimit të grupeve *mb* e *ng* në gegërishten, të cilat kanë dhënë përkatësisht *mb* e *ng*, tinguj fonetikisht të afër e prandaj dhe të shkëmbyeshëm. Në pikëpamje të etimologjisë *pëllëmbë pëllambë* hyn në ato fjalë të shqipes (trajtuar në Rev. d. Ling. VII 1 183), për të cilat vendi i theksit përbën një kriter për të dalluar a rrjedhin prej greqishtes a prej latinishtes. Ky vend tregon në mënyrë të prerë se kemi të bëjmë me një huazim grek. Po del pyetja ndërkaq nga cila periode e greqishtes vjen fjala. Përhapja e saj në mbarë shqipen dhe trajtimi fonetik (*a*-ja e pathekse e silabës së parë ndruar në *ë*, *a*-ja e theksuar e silabës së dytë ndruar në pozicion nazal toskërisht në *ë*, zhvillimi i një *b*-je si tingull homorganik pas *m*-së) dëshmojnë së bashku se kemi të bëjmë me një huazim mjaft të lashtë, mbase prej greq. së vjetër. Për nga forma *pëllambë pëllëmbë* nga *παλάμη* krahasohet me *shtambë shtëmbë*, edhe kjo huazim nga greq. e vjetër, nga *στάμνος*

përbalcë f. «luftim, beleg». G. Meyeri 332 e jep për të folët e Shkodrës, bashkë me *pelbazë* prej Rossit, dhe e shpie te it. *balzare* «me hovë» + *për-*. Poashtu Helbigu 82, i cili m'anë tjetër nga it. *balzare* spiegon dhe *vallcoj* «vallëzoj», e cila përkundrazi i përket natyrisht *valle-s*.

Bën pjesë në një grup fjalësh: Bardhi Palestra *Të marrë përbalcazë* (adverb), Bogdani *përbalcas*. Shihet se ka lidhje me *përbalt* «bëj me baltë», që e ka Budi (SC 252). Bardhi për «lutare, madefacere, oblimare»; khs. dhe *kamë perbaltja goj permjaltja* «duhet me hiek keq për me hanger mirë» (Leka II 27). Gurra e fjalës pra është *balta*. Idenë e dyluftimit e të atletit që lëfton (në palestër) shqipja e jep kësh-tu me të rrëzuarit për trolli e të përbalturit të kundërshtarit.

përcëllôj «djeg për cipe»; *përcëllij* «përcëlloj»; *përcëllák* m. «ku- laç i vogël pjekur në hi»; *përcëllimë përcëllinë* f. «livadh a pyll i dje- gur». Pas Kamardës (I 88) e afër me *përcjell përsjell* e me *çel* «ndez» e *nxit nxitoj* etj. Pas G. Meyerit f. 334 bashkë me *përskat* «spërkas, stërpik» nga serbokr. *prskati* «me stërpikë».

Forma dhe kuptimi i fjalës ndalojnë një bashkim me *përskat spërkas* që rrjedh prej sllavishtes. Afrimi me *përcjell përsjell* është bindës, po duke lënë jashtë *çel* e *nxit nxitoj* që e kanë vendin gjetiu. Do nisur nga *përcjell* me kuptimin e *përsjell* si një frekuentativ i *sjell*, pra me kuptimin «sjell rrotull disa herë përmbi zjarr». Edhe te Pedersenit 177 *përcjell* jepet me kuptimin «pushtoj, qerthëlloj». Te *përcëlloj* kuptimi është rezultativ, pra «rreshk duke sjellë e përsjellë përmbi zjarr». Te *përcjell* e *përcëlloj* ka një fortim të s-së në afrikatë përpara likuidës. Ruhet sibilanti në *përsëlenj përsëlonj* të shqipes së Greqisë, te Meyer Alb. Studien V 98.

përçllán m. «Hedera helix, urth». Mungon te G. Meyeri. Paraqitet në trajta të ndryshme nëpër dialektet e toskërishtes: Fjal. i gju. shqipe *përçllan*, Ed e Re (II Ser. III, shkurt 1931, f. 53) *përçlam*, te Tase *bushqan*, në Hoçisht (Devoll), *berçlen*, në Çervenakë (Mokër) *bër- shlém*; kjo e fundit bashkë me *bushqën* të Përmetit te Mitrushit 310. Huazim sllav: bullg. *bršlán* serbokr. *bršljan*, për të cilat sh. Berneker I 95. Si fjalë e Toskërisë rrjedh prej bullgarishtes. Andej dhe rum. *boroşlen*, gr. e re *μρούσλου μρούσλιάνη*, Miklosich Et. Wb. 21, G. Meyer NSt II 46. Forma *bushqan* paraqet ndrimin *kl:q*, nga një **bërshkklan* **brëshkklan*. Format me *p-* (*përçllan*, *përçlam*) kanë ndruar *b-* në nistore në *p-* për punë të artikulimit të ndryshëm të okluziveve në sllavishten e në shqipen; sh. për këtë Weigand Gram. 6v., Jokl LKU 74,156,299 v., 304. — Sllav. *bršljan* merret si një fjalë me burim të paditur, khs. dhe Mladenov 47. Mbase e afër brenda gjuhëve sllave, me *bl'uščъ* «urth», për të cilën sh. Berneker I 64v., Vasmer REW I 96, 378.

përdëllëj «kam mëshirë, mëshiroj; i shkoj për ngushullim, për kryeshëndoshë»; *përdëllim* m., *përdëllesë* f. «mëshirë, dhimsuni», *për- dëllimtar*, *përdëllestar*, *i përdëllëshëm* «që përdëllen, që ka mëshirë». G. Meyeri 299, duke u mbështetur në *përdëlej* e në të tjerat forma

me *l* palatale që s'ekzistojnë, ashtu si Hahni (f. 97) përpara tij, e bashkon fjalën me *ndëlej ndiej*, *ndëlesë* etj. nga lat. *indulgeo*. Pas La Pianës (Intorno al riflesso etj. f. 23) nga lat. *perdoleo*.

Fjalë e gjuhës kishtare. Nuk ka lidhje me *ndiej ndëlej*, sikundër tregon qartë ndryshimi i *l*-ve në të dy fjalët; khs. *përdellena Zot*; të *përdëlleftë Zoti* ke Kristoforidhi. Grafia e gabuar *përdëlej* buron prej Hahnit, i cili nuk ka dalluar mirë *l*-në palatale prej *ve*lares në gjuhën shqipe, sh. Pedersen 7v. Spiegimi i La Pianës përmban një thelb të drejtë, dhe e kemi pranuar edhe ne në *Revue de Linguistique* VII 1 168,196. Ka nevojë ndërkaq për një modifikim. Nuk kemi të bëjmë me *përdëllez* nga lat. *perdoleo*, e cila nuk ndeshet gjëkund në gjuhët romane, po kemi një formim *për-dëllez* zhvilluar përbrenda shqipes me preverbin *për-*. Fjala ka qenë **dëllëj*, e kjo rrjedh vërtet nga lat. *dolēre*, e cila rron në gjithë gjuhët romane duke përfshirë dhe rumanishten, sh. për të Meyer-Lübke REW 2721. Ky verb në shqipen nuk na del më si i tillë, po ruhet te postverbali *dullye* f. (shkruar *dšlye*) që na del si një *ἀμαξ εἰρημέων* te Buzuku: *ju qi ani bukënë e dullyesë* «qui manducatis panem doloris» (XI/2 e XII, Psalm 126.2), me një diftongim të *e*-së së gjatë latine si te *valëre: vëjyer*. Emra femërorë me *-ye* nuk mungojnë në gjuhën shqipe; khs. *fëndye* «fëndyell», *arësye* (te autorët e vjetër të Veriut mashk. *arësye arëseu*), *nue, nye*. Te *dullye* përkundrejt *përdëllez* ka ndrim të *ë*-së në *u* në pozicion përpara theksit. Emrin tjetër *dlesë* që jep Manni pas Aldegherit (Fjaluer latin-shqip) ne nuk e gjejmë në këtë fjalor, po gjejmë vetëm *përdlesë*, te fjalët *campassio, misericordia, pietas*.

përgjój, prigjój «rri fshehur e dëgjoj fjalët që thonë të tjerët; zë një vend të fshehur dhe vëzhgoj ç'bëjnë të tjerët; rri natën zgjuar e përbuj një të sëmure»; *përgjim* m. (sh. dhe *pregjim*); *përgjonës* m. «kallëzimtar, spiu»; *përgjueshëm* «kurioz». Kamarda (I 66, 113) lëkundet midis një afrimi me *gjegjem* «dëgjoj» e *gjuaj* dhe një tjetri me *qoj zgjoj*. G. Meyeri (f. 332) *përgjoj* e merr si të ardhur nga një **përglonj*, dhe si të tillë e nxjerr prej një lat. **pervigilare* (nga *vigilare* «ruaj»), poashtu si *zgjoj sqoj qoj* prej **exvigilare evigilare*. Pedersen (KZ 33,548) e grupon ndër ato fjalë që i gjen të spieguara gabim të G. Meyeri, po dhe ai ndërkaq pranon që *përgjoj* të ketë pasur një *l* pas gaturalit. Weigandi 68 e bashkon me *gjuaj gjuej*, poashtu si më parë alternativisht dhe Kamarda.

Fjalë e mbarë gjuhës. Del sëpari te Budi (DC 182b, 217a b, SC 21) 69, 157, 252, 331), me formë fonetiki të dykuptimshme (*përgjonj* ose *përgioni*): *Ashtu pritte se ndë tÿ Po vjen tue të përgjuom* (scil. vdekja); *Vonëte rreth vorrit tÿ, I vunë me përgjuom, Gjithë natënë gati; Mā parë tu përgjuom, S(h)trazëtarëtë e pānë, Përse gjithë qenë nguom; ndo mos mbāj kūjnaj mēnī, tue dëshëruom e tue e përgjuom me nkthiem të keq për të keq; sā herë ruojtunë mēnīnë tjerëve ndë zemërë e përgjuom për të keq; të vinjënë rreth e të përgjonjënë, poskūr maca minë; kundra gjithë anëmiqe tyne qi i përgjonjënë, e j vdonjënë mbë të keq*. Bardhi *Pervigil, Vigilante Përgiues, s(h)traznik*. Geg. veriore e sotmja *prigioj* në krahasim me trajtën e Budit e të Bardhit shihet se është sekundare përta i përket silabës së parë, duke treguar me këtë se fjala ka nisur në mbarë gjuhën me *për-*, poashtu si *përtoj: pritoj*; po ajo me *gi*-në e saj dëshmon se trajta bazë, si e pa dhe G. Meyeri me Pedersenin, ka qenë me *-gl-* në vend të së sotmes

-gj-. Me gjith'atë burimi nga një lat. **pervigilare* nuk është mendim që të bind; sh. dhe Rev. de Ling. VII 1 192: **pervigilare*, bazë e ri-ndërtuar, nuk del gjékund në gjuhët romane, prandaj nuk ngjan të ketë ekzistuar kurrë në latinishten; edhe kuptimisht *përgjoj* ka një sferë më të hapët se lat. **përvigilare*, sikundër shihet dhe nga përdorimet e fjalës te Budi. Ka të ngjarë që *përgjoj* të ketë dalë nga zbërthimi i *ndëgjoj ndëgjoj* në *ndë-gjoj ndë-gjoj*, me anë të një etimologjie popullore, duke u marrë ky verb sikur t'ish formuar me preverbin *ndë-*, e duke u zëvendësuar ky formant me *për-*. Në këtë cungim e riformim të *ndëgjoj* do të ketë pasur pjesë dhe afrimi kuptimor i kësaj fjale me *përgjoj*, e cila («rri fshehur, vë veshin e dëgjoj se ç'thonë të tjerët») në ndjenjën gjuhësore paraqitet si një intensivum i *ndëgjoj*. Ndërkaq kuptimi «rri natën zgjuar e përbuj një të sëmurë» do të jetë zhvilluar nga ndikimi i *zgjoj*, edhe kjo e afër nga forma me *përgjoj*. Kështu tri fjalë burimesh së ndryshme, *ndëgjoj*, *përgjoj* e *zgjoj*, janë përzier midis tyre, janë kryqëzuar në ndjenjën gjuhësore.

përkormë (i): sh. *kuar kuer*.

përlesë f. «baltë e pakët e rrëshqitë». Mungon te G. Meyeri, e ka Folklori I 14, pa ubikacion. Si e kemi shtjelluar te Bul. i Univ. Shtet. të Tiranës. Seria Shk. Shoq. 4 (1961) 180, kjo fjalë bashkë me *lyrë*, *lym*, *lyshhtër*, *lyth*, *lez. lerë* e ndonjë tjetër, është një postverbal i *lyej*. Më saktë rrjedh nga *përlyej*, poashtu si *përlym*; *përlesë* me -esë, *përlym* nga *përlym*, me ndikim edhe të sufiksit -im. Ndërkaq pranë *përlesë-s* ekziston dhe trajta e thjeshtë *lesë* «lerë», kjo drejtpërdrejt nga *lyej*.

përligj «shpërblej; justifikoj». Këtë fjalë, e cila mungon te G. Meyeri, Jokli (WuS XII 83vv.) e bashkon përbrenda shqipes me *ligje* «ligj; vejme, vome», *ligjoj*, *ligjohem* «rrëfëhem, kungohem, marr vojin te prifti», *ligjatë* «fjalim», *ligjëroj* «flas; qaj me ligje»; e në fushën indoeuropiane me lit. *lygùs* «i barabartë» *atlyginu* «shpërblej, shpaguaj» *lidzinât* «pajtoj; peshoj, paguaj, fejoj» let. *lidziba* «gjasi, parabull, shembëlltyrë; shpërblim» prus. e vj. *pōligu* «barabar», më tej me fjalën gjermanike got. *leik* «trup, mish, kufomë» *galeiks* «i barabartë» gjerm. *gleich* «barabar» etj. Krahasim i pranuar te Walde-Hofmann I 797.

Fjalë e geg. veriore. Mungon jo vetëm tek autorët e vjetër, po edhe te Kristoforidhi. E ka sëpari Bashkimi, *përligji* «contracambiare», *përligjë* f. «dovere, obbligo, soddisfazione, contracambio», pastaj **Bu-**setti për «compensare», Godini me *përligjë me ar* «me peshue me ar, mit Gold aufwiegen». Është gjë fort e dyshimtë që të jetë fjalë e gurrës popullore; më fort neologjizëm i rretheve letrare të Shkodrës, sikundër duket të tregojë dhe çfaqja e vonë e saj. Sido që të jetë kjo punë, *përligj* do gjykuar si një denominativ i *ligj-së*, kjo huazim nga lat. *lëgem*, me ndrim të e-së së gjatë në i ashtu si te *grëgem: grigj*. Afrimi i *përligj*, *ligjohem*, *ligjatë*, *ligjëroj* me *ligje* «ligj; vejme, vome» nga ana e Joklit qëndron, po të gjitha këto përfshihen te *ligj* nga lat.

lëgem. Nga kuptimi i ligjës ka dalë ai së drejtës (*ke ligj* «ke të drejtë» në shqipen e Greqisë). Prej andej u zhvilluan dhe përdorimet e verbit, si «shpërblej» (: «i jap të drejtën që i përket»), «justifikoj» e të tjera të afra me to. Për këto zhvillime kuptimesh khs. disa përdorime të ndryshme të emrit tek autorët e vjetër: *foli doktorëvet së ligjsë e farizejet, tue thashunë: A ashtë me ligj me shëndoshunë të shëtundenë? «dixit ad legis peritos et pharisaeos, dicens: Si licet sabbato curare?»* te Buzuku (LXXVIII = LXXXVIII, Luka 14, 3, Grigori *nd'është ndëjjerë të shëtunë të shëruajturitë?*, Kristoforidhi *Ndë qoftë se është udhës me shëndoshunë për të shëtunë?*), te Budi (DC 46, SC 65, 69, 71, 92) e *ato mundime... qi na... meritojmë, e kemi për ligj me j duruom, e me j pësuom* (me kuptimin «detyrë sipas së drejtës hyjnore»), *me ligj aj duhetë me qenë detorësi i gjith atë dami qi ata banjënë; me ligj të Tinëzot, e të shintesë kishë janë detuor e mbajtunë; o nd i qoftë me ligj t i venë kunorë; gjith ata priftënë o fratënë, qi ata t i cqidhnjinë e t u banjënë ligj pā mos rām mb udhë të shintesë pēndesë*, me kuptimin e rrugëdaljes, justifikimit. Nga të tilla përdorime të emrit u sajua verbi *përligj*. Ky ndërkaq gjatë dy brezave të përdorimit të tij ka pësuar ndryshime në kuptim, nga «shpërblej» u zhvillua në «justifikoj». — Fjala shqipe që i përgjigjet, si konkordancë parciale, grupit got. *leik galeiks* gjerm. *gleich* angl. *like* e lit. *lygūs* prus. e vj. *pōligu* etj., është *gjaj* «përgjaj», sh. këtë.

përlim m. «borxh, detyrë». Kjo fjalë e geg. veriore mungon te G. Meyeri. E ka Bashkimi për «convenienza», e dëshmon dhe Gazulli për të folët e Pukës, me kuptimin e borxhit: *me zbatue përlimin* «me la borxhin»; për Pukë e jep dhe Cordignano², për it. «debito» e «dovere». Jo një hapologji nga **përligjim* prej *përligj*. (Xhuvani Minerva III Nr. 27 f. 22, Kritikë mbi fjalorë të shqipes 31), po një postverbal i *përlyej*, sikundër mendon Logoreci (HD X 592v.), me arsyetimin e drejtë që borxhi gjykohet si diçka që përlyen, prandaj edhe *laj borxhin etj. përlim* ndaj *përlyej* si *lym* ndej primitivit *lyej* (sh. *lym*). Te *përlim* ka pasur një mbështetje pas emrave më *-im*; po khs. edhe emrin e lumit *Lim*, që përmban apelativin *lym* me ndrim të *y*-së në *i*. Nomen agentis *përlimtar* m. «refiner, polisher» që ka Manni di t'ishte një vërtetim i ri që *përlim* ka dalë nga *përlyej*, veçse nuk gjan të jetë fjalë e gjuhës popullore. — Sh. edhe *përlesë*.

përmbÿs «me bark e me fytyrë për dhë; me fund të kthyer nga sipër» (për një enë, një kazan etj.); *përmbÿs* «kthej përmbys; rrëzoj, hedh me forcë për dhë»; figurshëm «rrëzoj, prish rendin e mëparshëm, e sjell në një gjendje të përkundërt me të parën; e ndroj nga themeli»; *përmbÿsem*: *u përmbÿs barka*; *përmbÿsje* f. (neologjizëm). G. Meyeri 268 e barason me *mbÿs mÿyt, përmbÿtje*; kështu edhe Jokli Studien 56, Walde-Pokorny II 126, Walde-Hofmann I 259, Pokorny I 112. I padiskutueshëm spjegimi i Dozonit (f. 68) nga *për buzë*.

Fjalë e mbarë gjuhës. Si e kemi shtjelluar dhe te Bul. i Shk. Shoq. 1 (1958) 38v., trajta e vjetër e saj është me *m* të thjeshtë, jo me *mb*. Ashtu na e dëshmojnë më një anë dialektet e kolonive, më anë tjetër autorët e vjetër të Veriut: në Greqi verbi *prëmis*, në Siqeli (Z.

Skirò) *përmis* «vras» (edhe në Gjirokastër *përmbis* me këtë kuptim, në gjuhën e grave), në Contessa Entellina *përmisurë* «abbattuto, abbietto. cattivo», në Piana dei Greci adverbi *përmist* «përmbys»; sh. dhe Kamardën I 83; në Molizë ndërkaq *E Lazaru ngredi e u përbisi* (Lambertz IJ II f. 26). Budi (DC 213b. SC 62) *Gjithë përmys i rrëzoj; ò shtým e përmysunë*. Që *përmbys përmys përmis e mbys mbyt* janë dy fjalë të ndryshme, shihet dhe nga fleksioni i tyre, se e para bën në aorist *përmbysa përmysa*, e dyta *mbyta*. Për *përmbys* do nisur prandaj nga *përmys*, duke parë te *përmbys* shtesën e një b-je si tingull homorganik pas m-së, mbase dhe me një ndikim të *mbys mbyt*. Forma bazë ruhet te adverbi *përmys përmis*; andej u formua verbi, mbase më parë *kthej përmys* e pastaj si verb *përmys*. Adverbi është *për-mys*, ku pjesa tematike është *mys-i* m. «kurriz dheu që bëhet nga të punuarit e tokës me plug; trap, sop; pjesa e sipërme dhe e fryrë e bukës», *mysi i dorës* «kurrizi i dorës», *mys* «konveks, grahuq»; te Gazulli *mys* m. «koje, lkostër», *mys buke* «lkojë buke», *mysi i dheut* «lkostra e hollë qi ven toka e punueme». Kështu pra *mys* ka kuptimin «kurriz, shpinë» dhe *për-mys* është «për shpine», *përmist* e Siqelisë një lokativ më -t.

përmënd «zë ngoje, flas shkurt për të; zgjoj, sjell në vete një që e ka zënë gjumi a që i ka rënë të fikët». G. Meyeri 94 e jep pas Junggut si *përmën* «zë ngoje, emëroj» dhe e vendon te *emën emër*. Kuptimi «zgjoj, sjell në vete një që e ka zënë gjumi a që i ka rënë të fikët» është i tosk. jugore. Si e vuri re Weigandi (Balkan-Archiv I 260), fjala me të gjitha domethëniet është një verb denominativ i *mend mende-s*; *përmën* është trajtë dialektore me *nd* të asimiluar. Buzuku e ka dhe *promend*, si p.sh. (LVII, Gjoni 9,22) *se kush ta promendën se aj anshhtë Krishti* «ut si quis eum confiteretur esse Christum». Kjo formë është analogjike: meqë ky autor fjalët e huaja me *pro-*, si *profetë, provoj*, i jep shpesh dhe me një trajtë më popullore më *për-* (*përfetë, përvuom*, khs. edhe sot *proshut e përshutë*), ai anasjelltas *përmend* e ka ndryshuar në *promend*. Mundet ndërkaq që aty të kenë ndikuar edhe verbet sllave më *pro-*. Budi e ka rregullisht *përmend*, p.sh. SC 32 që *përmenda përsipëri*.

përmëlës (përmëleta) «ja prish kreshmët», *përmëletem* «prish kreshmët». Spiegimi nga serbokr. *iz-meljati* «me lye, me njollue» që jep G. Meyeri 333, ka dalë nga një vëzhgim i izoluar i fjalës, dhe s'ka gjetur vend te Selisçevi. Një vështrim i varianteve fonetike arrin t'i caktojë kësaj një tjetër vend brenda fjalorit të shqipes. Nuk mund të ndahet *përmëles* nga *përmbles përmblet, përbules purbulet* (Berati) e nga *burbules burbulet, burbulettem*, fjalë me kuptim të barabartë me *përmëles përmëletem*. Prandaj *burbulet burbulettem* nuk do marrë (me G. Meyer f. 54) si një fjalë me tjetër burim.

përpajnë f., më fort si pl. *përpajna-t* «degët e hardhisë që kallin në dhe për të zënë rrënjë, llashkë, kadoriqe»; *përpajnoj* «këllas degët e hardhisë në dhe që të zënë rrënjë». Fjalë e geg. veriore, mungon te G. Meyeri. E ka Junggu për «sermento», Bashkimi për «propag-

gine», bashkë me verbin *përpaajnoj*, me *përpaajnuë* «propagginare, sotterrare», poashtu dhe Cordignano, Bindoni për «propaggine, margotta». Xhuvani (Kritikë mbî fjalorë të shqipes 20) pyet mos është it. *propaggine*.

Del sëpari te Bogdani (II 142,4), me *-nj-* për të sotmen *-j-*: *anshtë çtrîm*, e *përpanjënuem* «si ë propagata». Në shqipen fjala e italishtes u përfshi në ndjenjën gjuhësore në kompozitet me *për-*. Kështu u zëvendësua it. *pro-* me *për-*, si te *përshut*, Buzuku *përfetë* pranë *profetë* etj. Khs. dhe *përpiloj*, nga it. *compilare*.

përpilój «hartoj një punim duke mbledhur lëndën andej-këtej e duke lidhur mendimet e të tjerëve me të miat; hartoj, formuloj (një shkresë)»; *përpilím* m. Neologjizëm i këtij brezi të fundit. Nga it. *compilare* «me përpilue»: me zberthim të preverbit *con-* e me zëvendësim artificial të tij me preverbin *për-* të shqipes. Për formime të këtij lloji khs. *fitoj përfitoj*, *përpaajnë*; sh. dhe *përgjoj* e *mbërzehen* te *ndërzéj*.

përpejtë «më të lartë, tërmá», adverb e parafjalë: *malit (malin) përpjetë*, *përpjeti malit* (Pedersen 177); *rëpjetë* «përpjetë»; *përpjetë*, *rëpjetë* *rëpitë* f. «vend përpjetë»; *i përpjetë*, *i përpjetëm*, te Weigandi *i përpjetshëm*; *përrëpitë (për-rëpitë)* «tërmá, thikë përpjetë; *i përpjetë*, *i rrëpintë*»; *tatëpjetë* «teposhtë», edhe parafjalë, si te *tatëpjetë malit*; *tatëpjetë* f.: e *përpjeta ka dhe tatëpjetën*. Pas G. Meyerit (f. 333v., Alb. Studien III 23,84, e më parë kas Kamardës I 304) e afër me ind. e vj. *pátati* «fluturon, ulet» gr. *πέτομαι* «fluturoj» lat. *peto* «drejtohem nga, përpqem të arrij, ja mësyj», për kuptimin më afër me ind. e vj. e me gr. *πίπτω* «bie», për formë e kuptim *sidomos* me *προπετής* «që bie përmbys, i pjerrët». Pranuar te Brugmann (Grundriss I² 511), Walde² 573, Ribezzo Riv. d'Albania II 146 shën. 2, Hofmann GEW 281. E kundërshton Pedersen (KZ 33,548), për punë të formave me *l* në shqipen e Greqisë e t'Italisë. te Kullurioti e *përpjel'ta*, *rëpjetë*, te de Rada *përpjël'*, Poashtu Jokli (Studien 14, LKU 164v.) e Walde-Hofmann II 282. Mbi këtë bazë Bariçi (I 75) rindërtonte për *përpjel'ta* një **plnó-* «rrëzuar», duke e afruar fjalën me lit. *pùolu* «bie», arm. *phul* «rrëzim», gjerm. *fallen* «me ra» etj.

Fjalë e mbarë gjuhës, e me një larmi formash më të madhe nga ç'kujtohet. Bardhi ka Supinus *Me mullë përpjetë*, f. 217 *S duhetë me luejtunë me gurë përpletë*, po kjo duket të jetë gabim shtypi për *përpjetë*, duke marrë radhitësi te *perpiete* e dorëshkrimi të tij *i-në* për *l*. Buzuku (LXI/2 = LXXI/2, Eksodi 14,27; LXXI/2 = LXXXI/2, Joeli 2,30) ka kompozitet *pjetiposhtë* «tatëpjetë» e *pjeti përma* «përpjetë»: e *dërgoi pjetiposhtë ata të Egjiptit ndë vjedmis detit* «et involvit eos Dominus in mediis fluctibus», *gjak e zjarm e tim qi të vë dëreq pjeti përma* «sanguinem, et ignem, et vaporem fumi». Nga *pjeti* shihet se edhe vetë *përpjetë* është një kompozit, *për-pjetë*, e *rë-pjetë* *rë-pjetë*, *tatëpjetë ta-të-pjetë*; pra forma e vërtetë e fjalës është *pjetë pjeti*. Më vonë edhe *përpjetë* e *rëpjetë* u ndien si forma të thjeshta, duke u pajisur përsëri me parafjalë e duke dhënë kështu më të *përpjetë* e *përrëpitë*. Me të drejtë Pedersen gjen te *pjeti* një

genitiv të varur nga *për*, duke krahasuar *pilikuri* «lakuriq» që shkon me *lakur*, *lëkurë*; meqë *për* ndërtohet me ablativ, te *pjeti* kemi të bëjmë më fort me një ablativ-dativ substantivi që dha një adverb, afërsisht ashtu si *krejt*; për kuptimin khs. *përmal* (*për-mal*) e *tërmal tërmá*. Nga kompozitet e Buzukut *pjetiposhtë* e ka dhe Bogdani, e sot si *pjediposhtë pidiposhtë* Malsia e Madhe e Pulti (Gazulli). Prej këtyre formave si bazë e fjalës na del një mashk. *pjet-i* ose një fem. *pjetë-a*. Prej këtij primitivi janë formuar dhe disa verbe: *pjetem* «rrënxohem, dëkohem», *i pjetun* «i dëkuem», *me u shpjetë* «me u pjetë», te Gazulli f. 408, *i cili* pa edhe afërinë e këtyre dy fjalëve. Kuptim të përkundërt ka *m'u spjetë* «me u ngjitë përpjetë»; për këtë e për *me spjetë* «me mbëritë², që ka po Gazulli sh. te *përspjetem*. Nga këto verbe, *pjetem* paraqitet e thjeshtë, *spjetem* me preverbin *s-* (sh. Xhuvani-Çabej, Bul. për Shk. Shoq. 4, 1956, 94) e *shpjetem* me *sh-*. Më ngushtë me *përpjetë* lidhet me *përpjetue* «me naltësue, me ngrehë përpjetë» që jep po Gazulli për Malsi të Madhe. — Te geg. *rëpitë rrëpitë* ka ndodhur një kryqëzim me fjalën *rrëpinë rrëpirë*.

Si e kemi shtjelluar dhe te Bul. i Univ. Shtet. të Tiranës, Seria Shk. Shoq. 1 (1958) 59v., për etimologjinë e fjalës do kthyer te mendimi i G. Meyerit. Nuk përbën një instancë kundër atij *përpjel'ta* e kolonive të Greqisë e t'Italisë. Ajo është një trajtë sekundare, që gjen spjegimin e saj brenda dialekteve: Në tosk. jugore *përpjetë* si emër ka dhënë me anë të një zgjerimi me *-lë përpjetëlë*. Nga një formë e tillë, ligjërimet e kolonive, të cilat kanë një afëri të ngushtë me tosk. jugore, nëpërmes të një metateze kanë arritur në *përpjel'të përpjel'ta*, formë më e lehtë në të shqiptuar; e me rënie të *-të-së*, që mund të jetë marrë si artikull postpozitiv, u arrit dhe në *përpjel'*. Pra te *pjeti pjetë përpjetë* e te verbi *pjetem* bashkë me *spjetem*, *shpjetem* e me *përpjetë* kemi refleksin e indoeur. *pet-*, gr. *πέτομαι προπεής* lat. *peto*, ind. e vj. *pátati* etj. Në shqipen fjala paraqitet me dy kuptimet e përkundërta «tërmal» e «leposhtë», te verbet me kuptimet «ngjitem» e «rrënxohem». Edhe në greqishten kemi kuptime fluturoj» e «bie». Për të tjerat gjuhë indoeuropiane khs. Ernout-Meillet 764. Thjesht morfologjikisht nuk mund të ndahet për shqipen nëse primar është emri (*pjeti*, *përpjetë*) apo verbi (*pjetem*). — Pa të drejtë Puscariu (EW 1455) *rëpjetë*, duke e shkëputur nga *përpjetë* e të tjerat variante të fjalës, e afron me rum. *repede* «shpejt, rrëmbyeshëm, thikë, përpjetë»; sh. për këtë te *i rreptë*.

përpúsh «trazoj, prushis (zjarrin) me mashë»; *përpushet pula* «gërryen pula dhenë që të gjejë ushqim, zhgurit»; figurshëm *mos u përpush* «mos m'u hidh përpjetë kështu, mos m'u ngërfos». Mungon te G. Meyerit. *përpush* është «prushis». Prandaj gjan të jetë **për-prush*, me zhdukje disimilatore të *r-së* së dytë, khs. *përpush* nga *përpurth* (te *pjerdh*) e *përqagze*; sh. dhe Xhuvani-Çabej, Bul. për Shk. Shoq. 4 (1956) 88. Është një nga ato fjalë që e kanë të përbashkët gegërishtja me shqipen e Greqisë: Reinholdi (Glosari 48) jep për këtë dialekt *përpushës* m. «mashë për të përpushur zjarrin, shkullorë». Preverbi *për-i* ka dhënë këtij verbi një kuptim faktiv-kauzativ ose intensiv.

përqell f. «turp, mbare». Spiegmin që i jep — me rezervë — G. Meyerit 225 (te *qëllonj*) kësaj fjale, nga lat. *percello* «qit rraha perdhë,

dërmoj», e kundërshton me të drejtë Pedersen (KZ 33,538 v.), për punë të karakterit velar të likuidës në fjalën shqipe.

Etimologjia latine nuk të bind as nga ana e kuptimit. Ky emër është një postverbal më -ë i përqell «përqesh, qesëndis», te Junggu «schernire»; te Bashkimi «dileggiare, offendere con obbrobri». Del që te Bogdani (I 105v.7): *essilla punë u pa ndë të rafunatë, ndë të përqellunit* «il che fu visto nella flagellazione nelli scherni»; edhe I 124, 2; 125, 4 (ludibrii, opprobrii), *po ende e përqelle* «anzi di lui ti burlasti» (I 169, 1). Ky verb përqell është një formë me për-i qell «bie, sjell; vonoj», që përdoret dhe me kuptim «tallem»; khs. *tue u qellunë me shokë* «duke bërë shaka, duke u sjellë, duke u tallur me shokë» te Buzuku XXI b. Khs. edhe *qell dhunë* «tall», e cila përveç se tek autorët e vjetër të Veriut del dhe në arbërishten e Italisë. Variantja pa apofoni e këtij verbi, *qall qallem*, ka dhënë përqallem, që metaforikisht përdoret për «i bëj lajka». Për këto forma e përdorime sh. te *qell*.

përqí f. «pajë». G. Meyeri 333 e jep për ligjërimin e Krujës, dhe e spiegon nga serbokr. *préjia* = bullg. sllav. e vj. *prikija*, këto nga gr. ere *προικίον* = gr. e vj. *προιός* «pajë». Spiegim i pranuar te Jokli LKU 78. Selisçevi nuk e numëron ndër elementet sllave të shqipes.

Ka një shtrirje më të madhe, meqë e ka dhe Budi (SC 71) : *mā ndë qoftë ashtu ndonjë impediment qi të mos japë ligja për gruo, t atillë aspak s duhetë me e cgidhunë, pā mos i dhanë përqinë e saj qi i përket*. Përhapja e fjalës në Shqipëri të mesme e mungesa e saj në Veri nuk flet në të mirë të një burimi prej serbokroatishtes. Është një huazim i pandërmjemë prej greqishtes mesjetare: *προικίον*, forma e përparme e së sotmes *προικίον*, deminutiv i gr. së vj. *προιός*. Prej asaj baze e kohe rrjedhin dhe format e gjuhëve sllave të Ballkanit që u dhanë më sipër. Poashtu trajtat *ta préjia* e *to priçi* «dono nuziale» të greqishtes së Italisë jugore, sh. Rohlf's EW 1790. Kemi të bëjmë gjithkund me ndikimin e Bizantit e të kishës bizantine në jetën e përditshme e familjare e në doke e zakone, sidomos të lindjes e të martesës. Aty nga fusha e shqipes hyjnë ndër të tjera *mirë, poganik, përgjim, shemër, shpërgâ shpagër, vë kurorë*, sh. dhe *fis, gjiri gjini*. Edhe si fjalë e gegërishtes, *përqí*, sipas kriterit që shtroi Thumbi (IF 26,7) e pas tij Jokli (IF 44, 38), është relativisht e vjetër në shqipen, sigurisht më e vjetër se tosk. *prikë* që është e një burimi me të. Më e re dhe arom. *prica*, për të cilën sh. Papahagi 877.

përspjetem (i) «arrij papritur, ja behi». Fjalë e geg. veriore, që mungon te G. Meyeri. Junggu *m'u pershpjët* «arrivare all improvviso», Bashkimi *me ja përspjetë* «far presto e senza interruzione» e *përspjetem* «arrivare improvviso», Cordignano *me ja përspjetë* «andare o arrivare presto, a tempo, far presto a senza interruzione», figurshëm «educar bene». Shq. Bardhi (HD XI 462) jep për Kosovë *ja përsphjeti* «ja befti, ja mbërrini beftas e mu në kohën qi duhet» dhe është kundra ndarjes së formave me s- e me sh-; gjithashtu dyshon në kuptimin «edukoj» që jep edhe Xhuvani (Kritikë mbi fjalorë të shqipes 14). Sipas tij Jokli ishte shprehur për një burim të fjalës prej sllavishtes, po pa i vënë gisht këtij burimi. Logoreci (HD X 593) gjen për këtë fjalë një afëri me *përsphetë* e farefisën e saj.

Në një këngë popullore prej Dukagjini gjejmë *Mali i Zi na u përspjët*, HD XIII 595. Me burimin sllav Jokli duket të ketë pasur parasysh serbokr. *prispjeti prispeti* «me mbëritë», gurrë e natyrshme për një fjalë të geg. veriore siç është kjo. Ndërkaq verbi i sllavishtes shihet se u ka kryqëzuar në truall të shqipes me disa fjalë vendi, e pikërisht me variantet e *pletet përpjetë* etj., siç janë *me u shpjetë* «me u pjetë, me u dëkue» e *m'u spjetë* «me u ngjitë përpjetë». Prej një kryqëzimi të tillë duhet të ketë dalë *me spjetë* «me përspjetë, me mbëritë, me behë» e Malsisë së Madhe (Gazulli). Kjo mund të merret ndërkaq dhe si një formë e dalë nga zbërthimi i *përspjetem* në *për-spjetem* në ndjenjën gjuhësore të popullit e nga një dalje aty e *spjetem* si një fjalë më vete.

përshtësh m. «gjellë me qumësht a me kos e me copëza bukë dërrudhur në të; kulaç i grirë pjekur në gjalpë dhe pastaj zier me lëng mi-shi». G. Meyeri këtë fjalë e jep në dy vise: f. 329 si *perçësh pershtësh* «supë me bukë», sipas tij nga turq. *parça* «copë» e *aş* «supë»; f. 355 si *pshesh* pas Dozonit «mets composé de blé bouilli, auquel on ajoute de la farine, et chez les gens aisés de l'huile et du miel», duke e çuar te një bazë *mshesh*, e këtë pas gjase prej bullg. *mësja* serbokr. *miješati* sllav. e vj. kishtarë *mëšati* «me përzie, me ngjeshë», mbase drejtpërdrejt nga bullg. *smés* «përzjerje», *zamés* «lloj gjelle».

Fjalë e mbarë gjuhës, si e kemi shtjelluar dhe te Bul. për Shk. Shoq. 3 (1954) 57 vv. Tosk. *përshtësh*, geg. *pshesh*, kjo me rënie të *r*-së në një grup tri konsonantesh. Në ishullin Hidra të Greqisë *prëshësh* (G. Meyer, Alb. Studien V 99), në Piana dei Greci të Sigelisë *përshësh*, po në S. Cristina Gela, katund aty pranë, *pshesh*; *përshësh* dhe në S. Marzano afër Tarentit në Apuli. Është edhe verbi denominativ *përshtësh bukën* «thërmoj, dërrudh bukën», figurshëm *përsheshi hundët* «coptoi, dërmoi hundët»; Kristoforidhi (Mateu 21,44) *ka me e përsheshunë* «conteret eum», Grigori *atë do ta bëjë pluhur*, Xanoni *kā për t'u zhublue*, te Ed. e Re (II, Ser. III, Nr. 1, janar 1931, f. 24) *me u përsheshë* «kur njëni rrxohet prej një shkrepit përsheshet, dërmohet». Gazulli *u përshesh guri*, figurshëm *janë vrā e përsheshë*. Metaforik është përdorimi i këtij emri në frazën *Gjen shesh, pa bën përshesh* « *Εύρίσκεις ἴσιωμα καὶ κάμνεις ἀνώμαλον* » te Mitko (f. 15 Nr. 134), pra «rrëmujë», përdorim që del nga kuptimi konkret i përsheshit. — Etimologjia e fjalës do të niset nga thelbi kuptimor i saj. Ky për verbin shihet se është «thërmoj», për emrin «gjë e thërmar». Prandaj fjala është një me *përshij* «thërmoj, dërrudh, bëj përshesh bukën», *përshihem* «thërmohem», që jep Kristoforidhi (f. 320) për gegërishten. Ky verb është një kompozit i *shij* «shkoq kokrrat e grurit në lëmë», si e vuri re mirë pky autor, dhe lidhet kështu me *fshij mëshij* etj., që varen po së andejmi (sh. *shij*). Nga *përshij* ka dalë emri *përshesh* e këndej verbi *përshesh*. Morfologjikisht *përshesh* duket të rrjedhë nga një më e vjetër **përshés*, zgjerim me *-es* si *shpërblés*, *shërbés*, *këndés*, *kujdés*, këto forma mashkullore pranë femëroreve *shpërblesë*, *gërresë*, *bresë* etj., sh. për këtë dukuri Jokl Studien 24, IF 36,137. Ky **përshés* do të ishte përgjegjësi mashkullor i *fshesë mëshesë-s*. Nga *përshés* arrihet te *përshësh* me rrugë fonetike, me anë në një asimilimi; khs. *shërbeshë* për *shërbesë* te G. Meyeri 404. Ndërkaq mund të ketë pasur me etimologji popullore dhe një lidhje

me *shesh*, në fraza si *gjen shesh pa bën përshesh*. Një tjetër zhvillim i *përshij* është *prish*, sh. këtë fjalë.

përshtát «pajtoj me disa rrethana të caktuara, adaptoj»; *përshtatem* «rregullohem pas rrethanave, jam në pajtim me to»; *përshtatje* f.; i *përshtatshëm* «që i përshtatet një pune, që bën për të». Mungon te G. Meyeri. Jokli (LKU 250) e afron përbrenda shqipes me *pështet mbështet* si edhe me *pushtoj* e me *shtuara*.

Është fjalë e re, jo e burimit popullor, që ka dalë pas botimit të Bashkimit (1908); Jokli e gjen te Elçija e vitit 1913. Është leksikalizimi i *për shtat*, në shprehje si *i bie për shtat* «i rri mirë (petku)». Një nga ato fjalë që kanë dalë në ngërthim të fjalisë. Si «verbe delokutive» të tilla khs. *bzāj bēzēj, ngarénd, vrej*.

përvjél «qeth dhentë te barku, te qafa e te bishti»; *përvjelë* f. «leshit' e qafës, të barkut e të bishtit të dhendve». Mungon te G. Meyeri. E ka Tase e Fjal. i gju. shqipe; *të përvjelat* «i thonë leshit të deles që ndodhet prapa kofshëvet dhe poshtë barkut» në Kurvelesh (Folklorë I 6). Pas J. Thomait (Bul. i Univ. Shtet. të Tiranës. Seria Shk. Shoq. 4, 1961, 143) *përvjel* dhe në Seman të Fierit, ku rron edhe emri i veprimit *përvjelje* f. Fjalë e gjuhës baritore, që gjer sot dëshmohet vetëm për toskërishten. Është një kompozit i *vjel*. Nga një kuptim i parë «këpus, nduk» u arrit më një anë te të vjelët e pemëve (sh. *vjel*), më anë tjetër te të qethurit e bagëtisë në disa pjesë të caktuara të trupit. Këtu thelbi kuptimor është «nduk», se të qethurit primitiv ka qenë një të ndukur. Sipas Hehnit (Kulturpflanzen und Haustiere⁴ 434) në Itali zakoni i të ndukurit të leshit të dhenve në vend të qethjes ruhej gjer në ditët e Varronit e të Plinit. Edhe në të tjera gjuhë kuptimet e vjeljes së pemëve e të ndukjes së leshit piqen në të njëjtat fjalë. Khs. lat. *carpo, -ere* «nduk, shkul (barin, leshin)» e «mbledh, këpus pemën», *carpiēs* «*ρουπατός πόκος*» te Ernout-Meillet 157. Edhe te reflektet e kësaj fjale latine në gjuhët romane dalin vise-vise të dy kuptimet, sh. Meyer-Lübke REW 1711.

përrallë f.; *përrallëz* f. «përrallë»; *përrallem* «shkoj kohën me muhabet; tallem, mahitem»; *përrallój përrallohem* «përrallem», *përrallis* «përrallem»; *përrallós* «bisedoj për punë pa rëndësi, përrallohem», *përrallosem* «përrallohem»; *përrallzatór* m. «ai që tregon përralla»; *përrallór, -e* neologjizëm. Në Siqeli *puçare*, në Greqi *puárëzë*. Nga lat. *parabola*, forma e Siqelisë e e Greqisë me atë metatezë që paraqet dhe span. *palabra*, port. *palavra* (sh. *pallavra*), dalm. (Veglia) *palaura*; sh. G. Meyer 350; Pedersen KZ 33,536, Weigand 68.

Fjalë e mbarë gjuhës. Del oë te Buzuku (XLV, Ezekieli 18.3: LXXXVI/2 = CVI/2, Timoteut II 4,4): *ata këha paret në folshinë ato fjalë për përrallë ndë Israelt* «si erit ultra vobis parabola haec in proverbium in Israel»; *të kthenenë përrallëvet* «ad fabulas autem convertentur», bashkë me *përrallës* m.: e *përrallësitë, e ata qi lypnjënë urtënë e të ditunit e udhënë e t ditunit* «et fabulatores, et exquisites prudentiae, et intelligentiae». Budi (SC 256) e *me sã ashtu ende tjera fjalë qe përrallunë e qëllunë dhunë*, sh. dhe SC 321. Edhe Bardhi ka *Fabula, favola Përralla, Fabulator Përrallës*; prandaj *për(r)allës* do të jetë një fjalë formuar përpara Buzukut, pas gjase në rrethet kishtare.

Sikurse kemi shënuar në Revue de Linguistique VII 1 183, *përrallë* është një nga ato huazime greko-latine të gjuhës shqipe, ku vendi i theksit dëfton se shqipja i ka marrë nga latinishtja (*parabola*), jo nga greqishtja (*παράβολή*). Është për të vënë re ndërkaq se shqipja me format *pyçare Puçrëzë* dalë nga një metatezë e fjalës, piqet, si u tha, me disa gjuhë romane perëndimore, me dalmatishten, spanishten e portugjishten. Zhvillimi fonetik për shqipen do të mendohet afërsisht si i kaluar nëpër rrugën lat. *parabola* **paraula*: shq. *përrallë*, me reduktimin *au*: *a*, si te *gaudium*: *gaz*, *laurus*: *lār*, *Paulus*: *Pāl*; khs. përkundrazi it. *parola*, frgj. *parole*. Fortimi i *r*-së te *përrallë* do gjykuar si një geminacion ekspresiv, i kuptueshëm në një fjalë afektive si kjo (khs. *përralla!*, *u bamë përrallë*). Për historinë e fjalës nuk është pa interes që lat. *parabole* — në kundërshtim me gjuhët romane perëndimore, ku, duke zëvendësuar fjalën *verbum*, ruhet përgjithësisht me kuptimin «fjalë» — në shqipen mori atë të përrallës, pas gjase nëpërmes të një përdorimi pejorativ ashtu si më vonë *pallavra-t*. Për «fjalë» shqipja mori nga latinishtja një tjetër element, *fabella*, e cila dha rregullisht fjalë. — Verbi *shpralloj* «hap andej e këtej fjalë që kam dëgjuar, duke shtuar shpeshherë edhe diçka nga vetja ime», bashkë me *shprallës*, fem. *shprallëse* «ai, ajo që shprallon», është formuar nga *përralloj*, *përrallem* me anë të preverbit *sh-*. Helbigu (f. 75), i cili e gjeti te Junggu me kuptimin e it. «sparlare», *t'shpralluem* «biasimato», pa të drejtë e spiegon nga it. *sparlare*.

pëshkój «shkoj nëpër duar këmishët për së dyti». Hahni e jep për tosk. jugore me kuptimin e gjerm. «reinige, wische ab», poashtu Kristoforidhi «*καθαρίζω, σκουπίζω*». G. Meyeri 336 mendon për këtë fjalë — me rezervë — një bazë **shkëponj*, e për këtë një burim nga it *scopare* «fshij me fshesë». Kështu edhe Helbigu 75.

Është, mund të thuhet, një fjalë e mbarë gjuhës. Ndërsa disa anë të Gegërisë, si Dibra, e kanë me këtë trajtë e këtë kuptim, për të folët e Përmetit në Jugë Kristoforidhi na jep *përshkój* «*ξεπλύγω, ξεβγάζω*» pra «shplaj»; poashtu e përdor dhe të folët e Konispolit. Pra kemi të bëjmë me *përshkój*, në gegërishten «e kaloj, e shkoj tejprtej (*përshkój fijen nëpër brimë të gjylpanës*), përgjithësisht edhe «e qep rrallë e përkohësisht prej njëres anë në tjetrën», bashkë me emrin *përshkim* m. «një të qepur rrallë»; te Weigandi 69 intrasitiv e transitiv. Sikundër shihet, fjala është një kompozit i *shkój* transitiv «kaloj» me preverbin *për-*, që i ka dhënë një kuptim faktiv-intensiv («e kaloj tejprtej»), po edhe iterativ («shkój edhe një herë nëpër duar»). Në dialektet ku mungon *përshkój* *pëshkój*, si në Gjirokastër, përdoret me atë kuptim e thjeshta *shkój*: *i shkova dhe një herë nëpër duar këmishët*. Këndej kuptohet dhe përdorimi «pastroj, fshij» që ka Hahni me Kristoforidhin; khs. shprehje të tilla si *shkoi një fshesë odës!* Për këto zhvillime kuptimore le të kihen parasysh it. *ripassare* frgj. *repasser* me përdorime teknike. Me këto kuptime *përshkój* është popullore; në të folët popullor ka ndodhur dhe të rënë e *r-së* te *pëshkój* në një grup tri konsonantesh, khs. *përshesh*: *pshesh*, *përse*: *pse*, *pështroj*: *pushtroj*: *pushtoj*, *pëshjtjell*. Si formim fjale *përshkój* është mjaft e vjetër, se e ka dhe shqipja e Greqisë e e Italisë: në Greqi *përshkonj* «ja kaloj», me *prë-* në karakteristike të atij dialekti në vend të më së përgjithshmes *për-*, sh. *prëcónëzë*; në Molizë intran-

sitiv *shkonj* e *përshkonj* «shkoj e kthehem» (Lambertz KZ 53,295); dhe te Cirese 22 *Shkoja* e *përshkoja* te *kjo rrugë e ngusht* «Passavo e ripassavo per questa strada angusta». Sot kuptimet popullore i ka mbuluar përdorimi i ri i gjuhës së shkrimit, «kaloj një vend nga njëra anë në tjetrën», i cili është përgjithësuar. Edhe ky ndërkaq rrënjët i ka në të folët popullor, te mediali *përshkohem*, në fraza si *jam përshkue në shumë të vështira*. Khs. dhe *përshkoj-në* e Molizes që sapo u zu ngoje.

R é s u m é

ETUDES D'ETYMOLOGIE ALBANAISE XVI

O.

oficér m. Plutôt qu'au roum. ofițer, la source immédiate de ce mot est à rechercher à l'all. Offizier, introduit en albanais par les troupes austro-hongroises pendant la première guerre mondiale.

okër m., f. «Triticum monococcum; Lathyrus ochrus» gesse ochre». De l'anc. gr. ὄχρος «Lathyrus cicera (dans Aristote et Théophraste), dont l'aspirée sourde est reflétée en albanais régulièrement par l'occlusive respectivo, comme dans lakër «chou; légume, herbes sauvages qu'on mange», et mokër «meule».

okóll «tout autour». Mot de l'albanais du nord, emprunt régional du serbo-cr. okolo.

oratë f., nom de poisson, Sparus auratus. De l'it. orata. La forme orade de l'albanais du nord vient du vén. orada, passé également en grec moderne.

orendi f. l. «ustensiles de ménage, meubles». Non pas de l'it. arredo «équipement, meubles» (G. Meyer), mais plutôt du sl. orodije «ustensile» (H. Pedersen).

ose «ou, ou bien», ose — ose «ou — ou» C'est une juxtaposition de o «ou» et se «que». Encore dans Buzuku la liaison des deux mots n'était pas complètement achevée, cette conjonction figurant chez lui sous la forme de deux mots séparés.

P.

pa «avant de» Pas identique à parë pari «avant» (N. Jokl), mais, au fond, le même mot que pa «sans», employé aussi en fonction temporelle.

pagëtyrë f. «rachat, rançon, récompense, paye.» Pas le reflet d'un latino-roman *pagatūra, non plus que detyrë «devoir, dette» est celui d'un *debitūra. Formation analogique du verbe paguaj «payer», d'après les noms en —tyrë lat. —tūra, comme fytyrë, kreatyrë, natyrë.

pagëzój «baptiser», pagëzim m. «baptême; baptistère», pagëzò pagëzimtar m. «celui qui baptise, Baptiste». Comme on sait, du lat, baptizare; il subsiste pourtant des difficultés l'ordre phonétique. Buzuku emploie pour «baptême» un mot d'autre provenance, bagëm.

pajandër f. «poutre de soutien dans un mur, lambourde». Du turc payanda «soutien d'un mur», mot qui a passé aussi en bulgare et en roumain.

pajt «grace à», mot de l'albanais de Sicile. Probablement de përanë të «par le moyen de» (littéralement «par le côté de»), par une ancienne palatalisation de l'n à nj et ensuite à j, comme dans ndaj «à côté, auprès.»

pajtoj est — comme l'a entrevu N. Jokl — un postverbal de paq «paix» dans toutes ses acceptions, dans celle de «louer; prendre quelqu'un dans son service» aussi bien que dans celle de «réconcilier», intrans. «s'accorder, cadrer». Aussi n'y a-t-il pas de place pour un lat. reconstruit *pactare comme base de pajtoj, et pour un *pactiare pour la variante pajcoj «réconcilier». La même chose vaut, à notre avis, pour les dérivés verbaux de lat. pactum dans les langues romanes, le sic. appattari «accomoder, accorder», esp. pechar «payer les taux», port. peitar «corrompre»: dérivés, à notre avis, respectivement du sic. pattu, esp. pecho et port. pieta (selon M. G. Rohlf's, par contre, sic. appattari d'un lat. *adpactare).

pakë f. «flèche de lard, quartier de lard», «si dice delle due pezze laterali di lardo del porco.» Emprunt germanique: anc. haut all. bahho, francon bakko, etc. qui revient dans l'anc frç. bacon. La voie de pénétration est encore à établir.

pakmós «au moins.» Juxtaposition de pak «peu» et mos «non, ne pas».

Päl «Paul». Du lat. Paulus. Forme à réduction de la diphthongue au à a, comme dans aurum: ār, paucus: pak, etc.

palaré f. «assiette plate; plat de grains, employé dans un office de morts». Non pas, ensemble avec le serbo-cr. poralija, de l'it. paiuolo «chaudron», mais du gr. moyen ἀπαλαρέα «plat, assiette; plat de grains employé dans un office de morts». L'aroum. palarie «cadeau de noces pour la nouvelle mariée» est considéré un emprunt de l'albanais, et une telle origine a été envisagée aussi pour le roum. pälărie «chapeau». Le même vaut également pour le serbo-cr. poralija.

palaví f. «saleté, crasse.» Comme l'a bien vu G. Meyer, un postverbal de laj «laver». Il s'agit, plus précisément, d'un substantif, formé du participe palá, palarë «non lavé, sale», à l'aide du suffixe -í, et avec un -v- contre l'hiatus.

palé «donc, or», particule qui exprime un ordre ou un appel et qui introduit une proposition impérative ou une interrogation indirecte. Non du serbo-cr. le «vraiment, pourtant» (G. Meyer), mais plutôt la lexicalisation de la proposition hortative pa le «laisse donc» (Kristoforidhi).

palëhúar, -ori m. «lieu dévasté». Emprunt régional du néo-gr. παλαιχώρι (παληχώρι) «chétif village, village perdu» (Kristoforidhi).

palnje panjë f. «érable.» Resté inexplicé chez G. Meyer, rapproché par N. Jokl au lat. palpāre «toucher légèrement de la main, tapoter, flatter; tâter, palper» palpitare «s'agiter vivement, palpiter» v. isl. falma «tâtonner, trembler de peur», gr. πελειζω «mouvoir avec violence, secouer, ébranler, faire trembler», ce nom d'arbre, issu

d'un *paltnje, est, à notre avis, le proche parent du gr. *πλάτανος* et de *πλατύς* «large, lit platūs «large», anc. ind. prthúh «large», etc. Le roum. paltin «érable, *Acer pseudoplatanus*» reflète, comme l'a remarqué N. Jokl, le mot albanais, plus précisément, une forme antérieure de ce mot.

paluze f. «espèce de gélatine». Emprunt du turc paluze même sens, ce mot dérivant à son tour du persan.

pall, pëllás pëllét «braire» (de l'âne) pallmë f. «braiment de l'âne» përpáll «tenêre publique, divulguer» shpall «proclamer, déclarer» shpallje f. «proclamation», dans F. Blanchus Mugire. Me pällunë, *Mugitus Pällmë, Mugitus bovis Pällma* e kaut. Inexpliqué (ou mal placé) chez G. Meyer p. 319, 320. Du groupe de lat. palam «en public, au yeux de tous», anc. russe polyj «ouvert, découvert» (N. Jokl, et déjà D. Camarda). Nous regroupons ici, en outre, le tochar. pal- «vanter, célébrer», rapproché par A. Meillet et M. E. Benveniste à tort du lit. balsas «voix, son, bruit», bylà «entretien, conversation» v. prus. billit «dire, parler».

pam «donc, voyons donc», dans Buzuku me pām pam a ishnë nēm ujënatë përmë dhët «ut videret si iam cessassent aquae super faciem terrae». Une juxtaposition: pa «donc, or» et la forme élidée du pronom personnel, më «me, à moi», issue dans des phrases du type Pa m u afërò «Accede huc», pour se généraliser ensuite dans des cas tels que pam a je biri em Ezau, a jo «utrum tu sis filius meus Esau, an non».

pameta «de nouveau». En usage surtout dans les parlars albanais d'Italie, ce mot représente une juxtaposition pa «donc, or» et le néo-gr. *μετά* «après». Même formation dans pagjene «enfin, ou bout des comptes» auprès de gjene «de nouveau». ce mot-ci du turc gene même sens.

pandërë f. «pièce d'étoffe brodée, longue et large d'un pied, que les femmes laissent pendre sur le giron». Plutôt que d'un lat. supposé *pant (ic) ārium, de pantex «tripes, intestins; panse», ce mot de l'albanais de Calabre provient de l'it. bandiera bandera «drapeau». Tout aussi vanderë «tablier» de l'albanais de Sicile, expliqué par G. Meyer d'un it. dialectal ventrera, remonte plutôt à une forme vernaculaire vendera de l'it. bandera.

pandispanjë f. «pain d'Espagne». De l'it. pan di Spagna, peut-être à travers le turc pandispanya. De la même source — non pas de l'it. pane di panico (G. Weigand) — provient le nom d'un autre gâteau, panikpán.

panë f. «écorce fine, pellicule, membrane.» De l'it. panna, mais, comme mot du tosqe méridional, probablement à travers le néo-gr. *πάνα πάννα* et *πανάδα* «cataracte des yeux», pénétré aussi en aroumain.

paqe f., **paq** m. «paix.» comme on le sait, du lat. pācem. Originaiement un fem. paq paq(j)a, les féminins de la troisième déclinaison latine ayant abouti en albanais à des féminins, avec chute régulière de la voyelle finale.

paqýll m. «homme déficient, stupide». A analyser probablement en pa-qyll, dont la partie radicale -qyll serait une variante de qull «bouillie, ragoût, sauce», mot employé aussi pour désigner une personne flasque et veule.

paramanë f. «épingle à cheveux, agrafe», paramandë, forme à -d- introduit après l'n. Du néo-gr. παραμάννα même sens (M. Lambertz).

paravësh m. «soufflet, gifle». C'est un composé para-vesh, mot-à-mot «avant-oreille», v. Xhuvani-Çabej Bul. Shk. Shoq. 4 (1956) 87. A confronter pour le sens l'all. Ohrfeige, l'anc. frç. et piém. orillon même sens, et le gr. παρήϊον παρειά «joue», proprement «endroit devant les oreilles».

parmendë, parmënde f. «charrue». Plutôt qu'un *peraramentum supposé, attesté seulement pour le latin médiéval de l'Allemagne (G. Meyer), ce mot continue un *paramentum qui survit dans l'it. paramento frç. parement, etc., ou bien apparamentun «préparation».

parzëm, parmëz f. «poitrine». Ni du serbo-cr. prsi prsa «poitrine» (G. Meyer), ni du lat. parma «bouclier rond» (M. Vasmer). La forme de base pármëzatë pl. attesté dans Gj. Buzuku, indique un diminutif pármëzë, dont le primitif parmë est identique à i parmë «antérieur, de devant». Cfr. pour le sens l'anc. frç. devant «poitrine», frç. moderne sur le devant du cheval. Le primitif parmë subsiste dans le pluriel parmat e fytit «carotides». Cfr. pour cela le gr. ἀντίας «glande de la gorge, amygdale; inflammation des glandes de la langue»: ἀντί «en face de».

parriz m. «paradis». Non de l'it. paradiso (G. Meyer, R. Helbig), mais du lat. paradisus (F. Miklosich, C. Tagliavini), comme le démontre aussi la chute de l'occlusive sonore intervocalique. Au gr. παράδεισος remontent au contraire parajsë e paradhís, dont le premier représente un emprunt plus ancien, le deuxième un plus récent.

pastër f., nom de poisson, «Pleuronectes platessa italicus». De l'it. (pesce passera; pastër deti un calque de l'it. passera di mare. Epenthèse de -t- dans le groupe sr comme dans nesër nestrë «demain».

pashnik m. «couverture grande-fine; essuie-main; linceul, suaire». Pas un emprunt au turc başlik «coiffure, couvre-chef» (G. Meyer), mot qui revient en albanais sous la forme bashllëk. Comme pacanik «grembiale delle montanare» qui reflète un *parcanik se rattachant à përparcë «tablier» (përpara «avant, devant»), tout aussi pashnik représente un *parsnik, une dérivation de para = përpara. Pour l'évolution phonétique cfr. vëshnik «égal en âge», de vërsnik.

pashtrák m. «droit d'herbage ou de pacage», «mercede o multa per pascoli». D'un lat. balcanique *pastüraticum, de pastūra, forme à suffixe -aticum (N. Jokl). Dans la région de Mati poshtrak.

pat m. «étage; chambre du premier étage.» Des diverses étymologies de ce mot: néo-gr. πάτος «fond, sol, fondement», lat. *pattus du gr. πάτος «chemin battu», lat. *pavatum, *patus lectus, patum ou patuum «idem est quod patulum id est locus patens et apertus», l'explication du néo-grec πάτος est la seule valable.

patështinë f. «marc (du vin), drague». Contrairement à l'avis de G. Meyer, qui reporte ce mot au serbo-cr. voština «restes de cire», on doit reconnaître une certaine parenté avec patitir «lieu où l'on foule

le raisin, pressoir», du néo-gr. **πατητήρ**, bien qu' une influence du suffixe slave -tina nē soit pas improbable.

pedim m. «frange». Comme nous enseigne N. Jokl, du roum. piedin «fond non tissé de la toile, frange». Insoutenable l'effort de H. Barić pour interpréter ce mot par les sources autochtones de l'albanais.

pëjnë f. «franae d'une robe.» Non Pas d'un lat. *pedinus «lisse» reconstruit (Candrea-Densusianu), mais le pluriel de pë peni «fil»: pëjna «fils», employé comme singulier, sinon tout droit comme pluriel.

pela-t «grosses vagues, flots» Probablement le pluriel æe pelë «jument». Cfr. pour le sens l'it. cavallone «gros cheval; vague de la mer» a cavalloni «à flots», le frç. moutons, et de l'albanais même l'expression vinë dallgët desh-desh.

pelë f. «jument». Le rapprochement avec le gr. **πῶλος** «poulain, pouliche; jeune animal; jeune fille», got fula, etc., est à retenir. A considérer aussi la comparaison ave l'irl. lair «jument», proposée par A. Fick et N. Jokl. Mot du fond indo-européen de l'albanais, à côté de mēz máz «poulain», mēshál «même sens», et kalë «cheval». A pelë semble appartenir pel'atoz «petite biche» de l'albanais de Sicile.

pellg m. «petite mare, flaque d'eau; endroit profond dans la mer, dans une rivière, etc». Rapproché par D. Camarda au gr. **πέλαγος** «la pleine mer», par G. Meyer au lit. pëlke «marais», gr. **παλός** **πηλός** lat. palus «marais», par H. Barić, sous une base *po-leugā, au lit. liūgas «flaque d'eau, bourbe», ce mot est considéré un emprunt du gr. **πέλαγος** par Walde-Pokorny, enfin par N. Jokl comme le proche parent de la peuplade illyrienne des **Πελαγόνες**. Plutôt un emprunt à **πέλαγος**, mot explicable avec les moyens internes du grec, qu'apparenté à ce mot sur une base indo-européenne. La forme originale pellëg supposée par N. Jokl, est attestée maintenant par les anciennes sources de la langue.

pendull f. «plume de l'oiseau». Dérivé de pendë même sens, à suffixe -ull, non pas l'emprunt d'un lat. *pinnula (Candrea-Densusianu). Aussi penlë «pennule, plumule» est un diminutif en -l(ë) de pendë et, comme telle, le même mot que pendël «plumule».

perëndi f. «Dieu», mot d'origine très discutée. Pour une provenance latine (imperantem, élargi en -i) sont Bopp et G. Meyer, pour une parenté indo-européenne (anc. slave Perunъ, lit. perkūnas, gr. **κεραυνός** «foudre», anc. ind. Parjanya-, etc.) H. Pedersen et d'autres savants après lui. H. Barić et M. V. Pisani trouvent dans -di de perëndi la correspondance de lat. Iovis gr. **Ζεύς**, etc. Des emplois tels que artë perëndia jote «veniat regnum tuum» dans P. Budi (1621), Caesar Perëndi, Imperator Perëndi turcice Sultan, Imperatrix Perëndesha dans F. Blanchus (1635), Perëndia e Turqisë «l'imperatore di Turchia», G. Cezarë Perëndin e Romësë «G. Cesare Imperator Romano», katër Perëndija «quattro Monarchie» dans P. Bogdani (1685), nous imposent de retourner à l'étymologie latine. C'est un mot profane entré dans le vocabulaire religieux: en origine un nom abstrait «domination; règne, empire», le mot a évolué à l'acception de «dieu».

perëndôn (dielli) «se coucher (du soleil), néo-gr. ὁ ἥλιος βασιλεύει. Dans la controverse, bien connue, si le point de départ de cette locution et à chercher dans le grec ou l'albanais, on doit donner raison à ces savants, qui — comme N. Jokl — soutiennent la dernière thèse. Le sens premier du verbe en albanais est en effet «s'incliner», dans telle région aussi perëndoj «appuyer» me u perëndue «s'appuyer», d'où le passage sémantique au sens de «coucher» (du soleil) est bien concevable. A notre avis aussi le roum. soarele asfînteşte «le soleil se couche», expression qui peut remonter également à l'albanais.

perikót m. «brique». Du vén. pieracota même sens.

perime fpl. «verdure, légumes», où peut rentrer aussi perihime «dessert» de l'albanais du sud (Labëria). Déformation (peut-être des cercles littéraires) de prime fpl. «remèdes de la médecine et magie populaires».

perishtúp, pirishtup «bissextile». Kristoforidhi a bien entrevu l'origine du mot, sans en préciser pourtant la source exacte. Emprunt régional du serbo-cr. pristupna (godina) «année bissextile».

perupí f. : v. porropí.

peshë f. «pierre qu'on jette, palet». Considéré par Miklosich, G. Meyer et d'autres linguistes identique à peshë «poids» du lat. pe(n)-sum, ce mot a été rattaché par H. Pedersen, sans ce dernier, à l'anc. ind. pansús av. pasnu- «poussière, sable», vieux sl. pesъkъ russe pesók «sable», comme un mot des sources indigènes. Pour des raisons sémantiques (πέτρα βαρεία, μεγάλη dans Kristoforidhi) et phonétiques aussi (une base *pens- supposée dans ce cas aurait donné un *pêshë en guègue du nord) est à préférer l'étymologie latine. — gurapësh est un composé à deux synonymes, type dobromirë «bon».

peshk m. «poisson», comme on le sait, du lat. piscis. peshkaqën, peshk-sqyt, peshk-sharrë, peshk-shpatë, etc. sont des calques d'it. pescecane, pesce scudo, pesce sega, pesce spada, etc. Des formes du nom, pishk est un pluriel singularisé, comme l'a bien remarqué G. Meyer: mais peshk ne représente aucunement un lat. *pescum. — Dans l'acception de «reins» qui comporte ce mot (Buzuku shtrëngo pishqitë e tû «Accinge lumbos tuos», actuellement peshku i kurrizit «épine dorsale, colonne vertébrale»), l'albanais se rapproche des langues romanes d'Occident.

pezëm m. «irritation, exaspération» pezmató j «irriter, exaspérer». Non pas du vieux sl. sьmeta «turbo», mais plutôt du gr πείσμα, comme avait bien deviné Kristoforidhi.

pëdhitë f. : v. podhé.

pëllás m. «palais». C'est un emprunt non de l'it palazzo, mais du lat. palatium, ainsi que l'avaient vu auparavant G. Meyer, et d'autres savants après lui, comme Meyer-Lübke, N. Jokl, P. Skok. Le mot latin survit aussi dans le serbo-cr. polača.

pëllëmbë pëllambë f. «paume de la main; palme; sifflet». La place de l'accent indique une origine de l'ancien grec (παλάμη), non du lat. palma. παλάμη à pëllambë pëllëmbë comme στάμνος à shtambë shtëmbë.

përbalcë f. «combat, duel». Non e l'it. balzare «bondir, sauter, caboter», mais le proche parent de përbalcas «lutteur, athlète» (Bogda-

ni) et du verbe përbált «lutare, madefacere, oblimare» de Blanchus, tous mots appartenant à baltë «boue, marais, argile, terre». Le concept du combat singulier est exprimé en albanais par l'idée du terrassement de l'adversaire.

përcëllój «flamber», përcëllák m. «petite galette rôtie dans la cendre», përcëllimë përcëllinë f. «prairie ou forêt brûlée» A rapprocher plutôt de përcjell përsjell au sens de «tourner de nouveau, retourner», que de përskát «arroser, asperger».

përçllán m. «lierre», aussi përcçllám, bushqán, etc. Emprunt slave. Comme mot de l'albanais du sud, du bulg. bręslján.

përdëlléj «avoir pitié; faire ces condoléances à qc.»; përdëllim m., përdëllësë f. «pitié, miséricorde», përdëllimtar, përdëllëstar, i përdëllëshëm «miséricordieux.» Non de ndëlléj ndëjëj «pardonner» du lat. indulgeo (G. Meyer), ni directement du lat. perdoleo (M. La Piana). C'est un composé përdëlléj, dont le primitif *dëlléj remonte au lat. dolëre. A *dëlléj répond, en qualité d'un postverbal, le substantif dullye de Buzuku, dans la phrase ju qi ani bukënë e dullfësë «qui manducatis panem doloris».

përgjój, prigjój «épier; garder un malade pendant la nuit» La dérivation d'un lat. *pervigilare, base reconstruite qui ne survit nulle part, ne convainc pas. Plutôt d'une décomposition de ndëgjoj «entendre, écouter» en ndë-gjoj, par voie d'une étymologie populaire, et d'un remplacement successif de ndë-, conçu faussement comme préverbe, par pë-.

përkórmë (i) : v. kuar kuer.

përlesë f. «limon, fange, bourbe, vase». Apparenté, à l'intérieur de la langue, à lyrë «graisse» lym «limon, bourbe, vase» lyshtër «limon, bourbe, vase», lyth «durillon, poireau», lez «marque (de naissance) envie, verrue», lerë «ordure, saleté, souillure», tous mots dérivant de lyej «oindre, enduire». Plus précisément përlesë dérive de përljej «encrasser, graisser».

përligj «récompenser; justifier». Pas un mot des sources autochtones, apparenté au lit. lygùs «égal» atlýginu «récompenser» letton lidziba «ressemblance, parabole; récompense», got. leik «corps, chair, cadavre», mais plutôt un néologisme, de ligj «loi», ce mot même du lat. lëgem. Cfr. pour l'emploi du mot albanais les tournures telles que (dans Buzuku) A anshtë me ligj me shëndoshunë të shëtundenë? «Si licet sabbato curare?» A ligj remontent tout aussi ligje «oraison funèbre», ligjëroj, etc.

përlím m. «dette, devoir». Pas une forme haplogologique, dérivant d'un *përligjim et ce mot même de përligj, mais un potsverbal de përljej «encrasser, graisser», tout aussi comme përlesë, et tout aussi comme lym «limon, bourbe, vase» qui provient du primitif lyej «oindre, enduire».

përmbýs «sur la face, la face contre terre», comme verbe «renverser, bouleverser; retourner (un verre)». Aucune parenté avec mbys mbyt «étouffer, asphyxier, étrangler; noyer», përmbytje f. «inondation, déluge». La véritable forme de l'adverbe, telle qu'elle ressort des

anciennes sources littéraires et des parlars archaïques des colonies de Grèce et d'Italie, est përmÿs përmÿs përmÿst, sans -b-; le même vaut pour le verbe. Appartient à mys m. «amas de terre soulevé par la charrue; petite colline, butte; croûte supérieure du pain», mys buke «croûte du pain», mysi i dorës «dos de la main».

përmënd «rappeler, mentionner; faire revenir à lui quelqu'un qui dort ou qui s'est évanoui». N'appartient pas à emën emër «nom» (G. Meyer), mais à mend mende «esprit, raison» (G. Weigand). Buzuku promënd, p. ex. sa kush ta promendën «ut si quis confiteretur», forme à remplacement de préfixe.

përmëlés «faire rompre le jeûne» përmëletem «rompre le jeûne». Pas un emprunt du serbo-cr. iz-meljati «oindre, tacheter», mais au fond identique à burbulët burbuletem employé au même sens.

përpjetë «de bas en haut»; comme adjectif, «escarpé», comme substantif «montée d'une pente». Pour ce mot il faut retourner à l'opinion de Camarda et de G. Meyer qui le rattachent au groupe de gr. πέτομαι «voler» πίπτω «tomber» προπετής «qui tombe en avant, qui se penche en avant, enclin; fougueux», lat. peto «se diriger vers, essayer d'atteindre, gagner», anc. ind. pátati «il vole, il s'élançe». La forme e përpjelta de l'albanais de Grèce et d'Italie, invoqué comme preuve contraire à cette étymologie, n'est qu'une metathèse de përpjetëlë du tosqe méridional.

përpÿsh «attiser», dans l'albanais de Grèce përpÿshës m. «tisonnier». Probablement de *për-prush, un dénominatif (factitif — causatif ou intensif) de prush «charbon ardent, braise».

përqellë f. «honte, deshonneur», n'est pas le reflet du lat. percello «frapper violemment; renverser, bouleverser; ruiner, détruire». S'est un postverbal de perqëll «railler, se moquer», dans Bogdani po ende e përqelle «anzi di lui ti burlasti», ceci un composé de qell «porter, emmener; retarder», qell dhunë «railler».

përqi f. «dot». Non du sermo-cr. pričija, mais directement du gr. (moyen) προικίον. Un reflet de l'époque byzantine, à laquelle l'albanais doit maints termes de cette catégorie, tels que mirë, poganik, shemër, shpërgâ shpagër, fis, gjiri gjini.

përspjjetem «arriver à l'improviste». Du serbo-cr. prispjeti prispjeti «arriver» (N. Jokl). Le verbe slave s'est combiné pourtant en albanais avec des mots de source indigène, pour donner des formes nouvelles prenant un sens particulier.

përshtësh pshesh m. «mets au lait ou lait caillé, avec dedans des petits morceaux de pain; galette morcelée et cuite au bouillon; mets composé de blé bouilli, auquel on ajoute de la farine, et chez les gens aisés, de l'huile et du miel». Enregistré par G. Meyer dans deux endroits divers de son Dictionnaire étymologique (p. 329 et 355), et considéré une fois comme mot turque, une autre comme slave, ce mot n'est qu'un postverbal de përshtij «émietter, broyer», ceci un composé de shij «battre le blé en grange», cfr. fshij mëshij «balayer, essuyer».

përshtât «adapter», përshtatem «s'adapter», përshtatje f. «adaptation», i përshtatshëm «convenant, convenable». Non pas le proche parent de pështët mbështët «appuyer», ni de pushtoj «embrasser; occuper, conquérir» ou de shtúara «debout». Un néologisme, un «verbe délocutif» à l'instar de bzâj bözëj, ngarënd, vrej, la lexicalisation

d'expressions telles que *i bie për shtat* «ça lui va bien, lui sied» (dit d'un vêtement), de *shtat* «stature, taille».

përvjël «londre les brebis au ventre, au cou et à la queue»; *përvjelë* f. «laine du cou, du ventre et de la queue des brebis». Un composé de viel «vendanger», au sens premier de «tirer, arracher, plumer». Cfr. pour la sémantique lat. *carpo -ere* «cueillir, arracher (l'herbe), brouter; détirer, démêler brin à brin (la laine, le lin); mettre en charpie, déchirer, découper», *carpies* «*ῥυπατός πόκος*» (Ernout-Meillet).

përrallë f. «conte», *përrallem* «s'entretenir, converser, passer le temps en badinant», *përrallës* m. «fabulator» *përrallór* «fabuleux», néologisme. Comme on le sait, provient du lat. *parabola*. Les variantes à métathèse des dialectes albanais de Sicile et de Grèce (*puçare*, *puárèzè*) rappellent les formes similaires de l'espagnol, du portugais et du dalmate, *palabra*, *palavra*, *palaura*. La place de l'accent atteste l'origine latine du mot, non grecque (*παράβολή*). Dans *parabola* **paraula*: alb. *përrallë* la diphtongue au s'est réduite à *a* comme dans *gaudium* : *gaz*, *laurus*: *lār*, *Paulus*: *Pāl*, contrairement à l'it. *parola*, frç. *parole*. Il y a eu dans *përralle*, en outre, une gémiation expressive de l'*r*. Il n'est pas sans intérêt que lat. *parabola* en albanais — contrairement aux langues romanes — survit au sens de «conte», et que pour «mot, parole» cette langue a adopté un autre terme du latin, *fabella*: *fjalë*. — Le verbe *shprralloj* «colporter des nouvelles, en y ajoutant souvent du propre, ébruiter, répandre», n'est qu'un composé de *përralloj*, le dénominatif de *përrallë*, non pas l'it. *sparlare* «décrier», comme pense R. Helbig.

pëshkój «repasser le linge en le rinçant». En partant de l'acception «nettoyer, essuyer», donnée par Hahn, G. Meyer songe à une forme de base **shkëponj*, dérivée de l'it. *scopare*. Ce n'est que *pëshkój* «repasser», le factitif-intensif, ou bien le fréquentatif de *shkój* «passer». Cfr. pour le sens l'it. *ripassare* et le frç. *repasser*. La chute de l'*r* comme dans *pëshshësh*: *pshesh*, *përsé*: *pse*. *pështroj* *pushtroj*: *pushtoj*, etc.

përpajné f. «provin, marcotte», *përpajnoj* «marcotter», dans P. *Bogdani* «propager». De l'it. *propaggine* même sens.

përpilój «composer, rédiger, compiler», *përpilím* m. Néologisme. De l'it. *compilare* «compiler; composer», en substituant au préverbe italien *con-* l'alb. *për-*.

Supplément au numéro XV:

ndoshta «peut-être». Non pas un adverbe *ndothta* d'aventure», de *ndodh* *ndodhem* «se trouver, être la par hasard» (F. Konitza), mais originellement un emprunt régional au serbo-cr. *doista* «vraiment, certes», avec un affaiblissement de sens, comme dans le gr. *μισάαλτ* «à peu près, environ», de «tout au plus» et l'all. *fast* «Presque», de *fest* «ferme».

1875

Received of the Treasurer of the County of ... the sum of ... Dollars for ...

Witness my hand and the seal of the County of ... this ... day of ... 1875.

County Clerk

Received of the Treasurer of the County of ... the sum of ... Dollars for ...

Witness my hand and the seal of the County of ... this ... day of ... 1875.

County Clerk

Received of the Treasurer of the County of ... the sum of ... Dollars for ...

Witness my hand and the seal of the County of ... this ... day of ... 1875.

County Clerk

Received of the Treasurer of the County of ... the sum of ... Dollars for ...

Witness my hand and the seal of the County of ... this ... day of ... 1875.